

“EURO STEEL” SH.P.K.

RAMUN, KOMUNA PEJË



RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR QENDRËN E MBLEDHJES, GRUMBULLIMIT, TRANSPORTIMIT, TRAJTIMIT FIZIK, RIPERDORIMIT, PËRPUNIMIT DHE MAGAZINIMIT TË MBETURINAVE TË LETRËS, PLASTIKËS, ÇELQIT, MBETURINAVE METALIKE DHE VAJRAVE TË PËRDORURA

Pejë, Shkurt – 2025



RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR QENDRËN E MBLEDHJES, GRUMBULLIMIT, TRANSPORTIMIT, TRAJTIMIT FIZIK, RIPËRDORIMIT, PËRPUNIMIT DHE MAGAZINIMIT TË MBETURINAVE TË LETRËS, PLASTIKËS, QELQIT, MBETURINAVE METALIKE DHE VAJRAVE TË PËRDORURA NGA KOMPANIA “EURO STEEL” SH.P.K., RAMUN, KOMUNA PEJË

Ngastra me nr. 00001-121, Zona kadastrale Ramun, Komuna e Pejë

	Emri I Investitorit
Aplikuesi	Avni Latifaj, Drejtor i Kompanis Ermal Latifaj, Person Përgjegjës
Investitori	“EURO STEEL” SH.P.K.
Adresa:	Zahir Pajaziti
Lokacioni i Fabrikës	Ramun, komuna e Pejës
Tel:	+383 45 500 725
Email:	eurosteel10@gmail.com

Investitori:

“EURO STEEL” SH.P.K.



Emri i Hartuesit të Raportit të VNM-së

Bsc. Hidro. Blerina Bajraktari

Nënshkrimi

Blerinabajraktari1@gmail.com

+383 49 588 634

PËRMBAJTJA:

1.	HYRJE	1
2.	KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së	2
3.	PËR KOMPANINË	3
a)	Vendndodhja e Fabrikës.....	5
b)	Përshkrimi i veçorive kryesore Fizike të Projektit	7
c)	Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit.....	7
d)	Lënda e pare dhe lënda ndihmëse.....	8
e)	Përshkrimi detal i procesit teknologjik.....	9
f)	Përlllogaritja sipas llojit dhe sasisë të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjate fazës së operimit	14
4.	PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TE ARSYESHME	16
5.	GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT	18
5.1.	Flora dhe Fauna	18
5.2	Hidrografia.....	19
5.3	Ndotesit Kryesorë.....	20
5.4	Transporti rrugor.....	21
5.5	Mbeturinat e ngurta	21
5.6	Ndotësit nga burimet agro-kemikale	21
6.	IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS	22
6.1.	Ndikimet në ajër	22
6.2.	Ndikimet në tokë	23
6.3.	Ndikimet në ujë	24
6.4.	Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë	25
6.5.	Ndikimet në vendbanime dhe popullatë	26
6.6.	Ndikimet nga zhurma	26
6.7.	Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore	26
6.8.	Ndikimi mjedisor nga mbeturinat.....	27
6.9.	Trashëgimia Kulturore.....	27

7.	PËRSHKRIMI I PASOJAVE TË MUNDËSHME NË MJEDIS	28
8.	PËRSHKRIMI I METODAVE PËR VLERËSIMIN E PASOJAVE MJEDISORE	29
9.	PËRSHKRIMI I MASAVE	31
9.1.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër	31
9.2.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë	32
9.3.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë	32
9.4.	Masat për mbrojtje nga zhurma	33
9.5.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë	34
9.6.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë	35
9.7.	Masat për menaxhimin e mbeturinave	36
9.8.	Masat rehabilituese	36
9.9.	Komponentë mjedisore, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve	38
10.	PËRSHKRIMI I PASOJAVE NEGATIVE MJEDISORE	39
11.	MONITORIMI DHE RAPORTIMI	40
12.	PËRFUNDIM	41
13.	FORMA TABELARE E KOSTOS INVESTIVE	43
14.	LITERATURA E PERDORUR	44

Lista e Figurave

Figura 1.	Shtrirja hapësinore e lokacionit të kompanisë në territorin e komunës së Pejës	5
Figura 2.	Distanca e kompanisë me qytetin e Pejës	6
Figura 3.	Distanca me e fabrikës nga shtëpi banimi	6
Figura 4	Skemat e Procesit Teknologjik	11
Figura 5.	Rrjeti Hidrografik në K. Pejë	19

Lista e Tabelave

Tabela 1.	Kodet e mbeturinave të cilat i grumbullojnë dhe punon me to.	4
Tabela 2.	Llojet e kodeve dhe mënyra e trajtimit	12

1. HYRJE

Hartimi i Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) për qendrën e mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit dhe magazinimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura është një kërkesë e rëndësishme e parashikuar nga Ligji nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis. Ky raport ka për qëllim të sigurojë që kompania “EURO STEEL” SH.P.K. do të veprojë në përputhje me standardet mjedisore të vendosura nga legjislacioni kombëtar dhe ndërkombëtar për menaxhimin e mbeturinave. Kjo përfshin respektimin e normave për ndotjen e ajrit, kontrollin e emisioneve dhe mbrojtjen e burimeve ujore dhe tokësore.

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është një dokument kyç dhe i domosdoshëm për marrjen e Pëlqimit Mjedisor për ndërtimin dhe funksionimin e qendrës së mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit dhe magazinimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura, të cilat mund të krijojnë potencialisht ndotës të ndryshëm që duhet të vlerësohen për ndikimin e tyre në ajër, ujë dhe tokë. Ky raport ka për qëllim të paraqesë ndikimet e mundshme që mund të lindin nga aktivitetet e planifikuara dhe të propozojë masat për minimizimin e tyre në mënyrë që të ruhet mjedisi.

Përmes këtij Raporti të VNM, do të përkufizohen të gjitha ndikimet që mund të paraqiten në proceset e mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit dhe magazinimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura nga kompania “EURO STEEL” SH.P.K., e cila do të ndërtohet në Zonën Kadastrale Ramun, Komuna e Pejës. Ky vlerësim do të bëhet duke marrë parasysh mjedisin jetësor të ngushtë dhe të gjerë, si dhe karakteristikat e lokacionit të propozuar për ndërtim.

Hartimi i raportit për vlerësimin e ndikimit në mjedis ka për qëllim që të paraqesë ndikimin potencial në mjedis për aktivitetet e grumbullimit, seleksionimit, presimit dhe ambalazhimit të mbeturinave të letrës, plastikës, kanaçeve të aluminit, makinave të vjetra, baterive dhe vajrave të përdorura. Kjo përfshin edhe analizën e veprimtarive përcjellëse dhe të gjitha proceseve të punës, duke siguruar që të mundësohet ruajtja e mjedisit gjatë fazës së operimit.

Ky vlerësim i ndikimit në mjedis është hartuar duke u bazuar në analizën e kërkesave të operatorëve, gjendjen aktuale të lokacionit, karakteristikat e tij dhe gjendjen ekzistuese të mjedisit përreth zonës ku parashikohet të ndërtohet objekti. Po ashtu, është marrë parasysh edhe dokumentacioni teknik ekzistues. Detyra e përgatitjes së këtij raporti është identifikimi i

burimeve të mundshme të ndotjes, vlerësimi i ndikimit të këtyre burimeve në mjedis, si dhe propozimi i masave për parandalimin ose zvogëlimin e ndikimeve negative deri në nivelet e lejuara. Të gjitha konstatimet dhe rekomandimet për mbrojtjen e mjedisit që do të dalin nga ky raport, do të duhet të merren në konsideratë gjatë fazës së operimit të objektit, pasi kompania ende nuk ka filluar ndërtimin e objektit, por është në proces të planifikimit dhe përgatitjes për ndërtim.

Në përfundim, ky raport ka për qëllim të sigurojë një vlerësim të plotë dhe transparent të ndikimeve të mundshme mjedisore që mund të ndodhin gjatë fazave të ndërtimit dhe operimit të qendrës për menaxhimin e mbeturinave, dhe të paraqesë masat e nevojshme për parandalimin e ndotjes dhe ruajtjen e një mjedisi të shëndetshëm për komunitetin dhe ekosistemin përreth.

2. KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së

Bazuar në karakteristikat e grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit dhe magazinimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura me të gjithë infrastrukturën përcjellëse dhe sipas projektit të përfunduar, ku ky projekt është subjekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis. Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis i cili është baza kryesore ligjore të cilit ju kemi referuar.

Shtojca 1 e këtij ligji, paragrafi 8:

Për përgatitjen e këtij raporti janë konsultuar edhe ligje të tjera relevante, si:

Ligjet:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025;
- Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.08/L-181;
- Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060;
- Ligji nr. 08/l-071 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/l-060 për mbeturina
- Ligji për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174;
- Ligji për Tokën Bujqësore Nr. 02/L- 26;
- Ligji për Mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102;
- Ligji për Ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147;
- Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 08/L-025;
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr.03/L-233;
- Ligji për Mbrojtje nga Zjarri Nr. 08/L-261.
- Ligi për Ndërtim Nr. 04/L-110.

Udhëzimet Administrative:

- Udhëzim administrativ Nr.13/2013 për Katalogun Shtetëror të Mbeturinave;
- Udhëzimi administrativ (QRK)-Nr.03/2021 për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme;
- Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes;
- Udhëzimi administrativ Nr.02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor;

Pasi që për këtë veprimtari është e nevojshme të bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM), atëherë për të adresuar ndikimet mjedisore të mundshme, masat për zvogëlimin e ndikimeve dhe përputhshmërinë ligjore, investitori ka vendosur që të kryej një studim përkatës të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të përgatis raportin dhe të aplikojë për pëlqim mjedisor në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH).

3. PËR KOMPANINË

Eurosteel është themeluar në vitin 2001 në Pejë, zanafillën e vet e ka që nga fillimi i viteve 70, kur i ndjeri Rexhep Latifi babai i pronarëve të sotëm ka qenë i punësuar në ndërmarrjen e atëherëshme Hekurishta “Kosova Sirovina” në të cilën punoj deri në pension dhe të njëjtën djemët e tij Fahriu, Aliu dhe Avniu privatizuan këtë ndërmarrje në vitin 2006. EUROSTEEL tani është një kompani shumë e suksesshme në tregun Kosovar që merret me aktivitete të ndryshme të reciklimit kompania e cila si veprimtari kryesore ka grumbullimin, magazinimin e lëndëve sekundare të: hekurit, aluminit, bakrit, plastikës dhe lëndëve tjera. Kompania “EURO STEEL” SH.P.K., do të vendoset në Ramun, Komuna Pejë, është një fabrikë e specializuar në grumbullimin, transportimin, trajtimin fizik, ripërdorimit, përpunimit dhe magazinimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura. Fabrika është angazhuar në trajtimin e mbetjeve me standarde të larta mjedisore dhe shëndetësore, duke përfshirë metoda të sigurta për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme që mbrojnë mjedisin dhe shëndetin publik.

Krijimi i një zinxhiri afatgjatë mjedisor dhe të qëndrueshëm me rregulloret, financimi i grumbullimit dhe rast të shëndetshëm të biznesit për klasifikim dhe riciklimin e mbeturinave, të cilat janë:

- ✓ Pastrimi i mbeturinave komunale në oborre, toke komunale apo zonave industriale
- ✓ Krijimi i sistemit për mbeturinat e rrezikshme
- ✓ Krijimi grumbullimi dhe trajtimi i mbetjeve elektronike

Moto e kompanisë është të jenë lider në industrinë e riciklimit në tregun kosovarë si dhe motoja e ruajtjes së ambientit “Kosova e Pastër” është:

- Reduktim
- Ripërdorim
- Reciklim

Kompania për momentin nuk bën riciklimin e mbeturinave.

Me poshtë kemi paraqitur tabelën e te gjitha kodeve te cilat i grumbullon kompania .

Tabela 1. Kodet e mbeturinave te cilat i grumbullon dhe punon me to.

Tabelave e kodeve te mbeturinave me te cilat do te punoj kompania “EURO STEEL” SH.P.K.				
02 01 04	15 01 09	16 02 14	17 04 01	20 01 02
02 01 10	15 02 02 *	16 02 15*	17 04 02	20 01 10
03 03 08	16 01 03	16 02 16	17 04 03	20 01 11
07 02 03*	16 01 04*	16 06 01*	17 04 04	20 01 23*
07 02 13	16 01 06	16 06 02*	17 04 05	20 01 25
10 03 05	16 01 07*	16 06 03*	17 04 06	20 01 33*
12 01 07*	16 01 09*	16 06 04	17 04 07	20 01 34
12 01 10*	16 01 17	16 06 05	19 12 01	20 01 35*
13 04 01*	16 01 18	16 06 06*	19 12 02	20 01 36
15 01 01	16 01 19	16 07 08*	19 12 03	20 01 38
15 01 02	16 01 20	16 08 01	19 12 04	20 01 39
15 01 03	16 02 09*	16 08 02*	19 12 05	20 01 40
15 01 04	16 02 10*	16 08 03	19 12 07	20 03 01
15 01 05	16 02 11*	17 02 01	19 12 08	
15 01 06	16 02 12*	17 02 02	19 12 12	
15 01 07	16 02 13*	17 02 03	20 01 01	

Kjo kompani do te hap vendeve të reja të punës, zvoglimin e sasisë së mbeturinave në territorin e Komunës së Pejës dhe më gjerë dhe zhvillimi i ndërmarrjes EUROSTEEL. Eurosteel aktualisht ne te gjitha veprimtarie ka te punesuar 70 punëtor me orar të plotë, projekti i ri i riciklimit ka synim të punësoj së paku edhe 67 punëtor, ku synojnë edhe veprimtarin e riciklimit, Eurosteel pra synon të dyfishojë numrin e punëtorëve. Kompania ka qenë në

lokacion tjetër tani ka planifikuar që të hapë këtë pikë të re dhe të aplikoj për marrje e pëlqimit Mjedisor do ta ndërtoj lokacionin.

a) Vëndndodhja e Fabrikës

Objekti i grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit dhe magazinimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura, do të ndërtohet në ngastrën kadastrale me nr. 00001-121, Zona kadastrale Ramun, komuna e Pejës.



Figura 1. Shtirirja hapësinore e lokacionit të kompanisë në territorin e komunës së Pejës

Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis për grumbullimin, transportimin, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit dhe magazinimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura nga kompania “EURO STEEL” SH.P.K., zona kadastrale Ramun, komuna Pejë.

Lokacioni ku do të ndërtohet qendra për grumbullimin e mbeturinave, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit dhe magazinimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura, është me largësi nga qyteti i Pejës diku afër 10.4 km distance.




Figura 2. Distanca e kompanisë me qytetin e Pejës

Në afërsi të qendrës për grumbullimin, transportimin, trajtimin fizik, ripërdorimit, përpunimit dhe magazinimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura, nuk kemi shtëpi bani afër, distanca me e afërt me shtëpi banimi është mbi 450 m, ndërsa kemi afër aktivitete tjera industriale pasi që kjo zonë kadastrale në Ramun të komunës së Pejës, është zone industriale dhe të gjitha objektet janë me aktivitet industrial..




Figura 3. Distanca me e fabrikës nga shtëpi banimi

b) Përshkrimi i veçorive kryesore Fizike të Projektit

Me poshtë paraqesim përshkrimin e veçorive kryesore të fazës operative të qendrës së mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit dhe magazinimit, të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura nga kompania “EURO STEEL” SH.P.K.

Kjo qendër për mbeturina do të vendoset në Zonën Kadastrale Ramun të Komunës së Pejës. Për kompaninë, “EURO STEEL” SH.P.K. më poshtë do të paraqesim veçoritë fizike të këtij projekti që planifikohet ti ketë:

Objekti ekonomik – halla presimit, ndarjet dhe përpunimit, objekti është ndërtuar me pllakën nga beton arme, shtylla nga qeliku dhe muret e jashtme nga llamarinat dhe kulme nga konstruksioni i metalit i sistemi kapriat për shkak të hapësirës së madhe dhe mbulesa është e llamarinës. Në këtë objekte janë instaluar vijat teknologjike të prodhimit. Po ashtu mbrenda planifikohet të jetë edhe objekti administrativ ku do të jetë i ndar me pllaka të allçisë.

c) Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit

Faza operative e projektit të qendrës për grumbullimin, transportimin, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit dhe magazinimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura përfshin disa procese kryesore që synojnë përpunimin e mbetjeve të ndryshme në mënyrë të qëndrueshme dhe efikase. Kjo fazë është thelbësore për transformimin e materialeve të grumbulluara në produkte të tjera të gatshme për ruajtje, transport, magazinim, ripërdorim dhe riciklim, duke reduktuar ndotjen dhe duke siguruar menaxhim të sigurt të materialeve. Proceset e fazës operative do të përfshijnë: grumbullimin e mbetjeve nga burime të ndryshme, seleksionimin për ndarjen e materialeve të ndryshme si plastika, letër, kanaçe alumini dhe bateri, pastrimin dhe përpunimin e materialeve për t'i bërë ato të gatshme për presim, presimin për uljen e vëllimit dhe krijimin e formave të menaxhueshme, dhe ambalazhimin për ruajtjen dhe transportimin e sigurt të materialeve. Në këtë fazë, përdoren teknologji dhe makineri moderne për të siguruar efikasitetin e procesit dhe për të minimizuar ndikimet negative në mjedis, duke përfshirë monitorimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe të ndikimeve mjedisore. Kjo fazë operon gjithashtu për të siguruar që mbeturinat të ruhen dhe transportohen në përputhje me rregulloret mjedisore, duke kontribuar në riciklimin dhe menaxhimin efikas të mbetjeve.

d) Lënda e parë dhe lënda ndihmëse

Në kontekstin e projektit për grumbullimin, transportimin, trajtimin fizik, ripërdorimit, përpunimit dhe magazinimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura, lënda e parë dhe lënda ndihmëse përfshijnë materialet dhe burimet që janë të nevojshme për të realizuar proceset e përpunimit të mbetjeve dhe për të siguruar operimin efikas të qendrës. Furnizim me lende të parë bëhet nga deponit e vogela të mbeturinave metalike.

Lënda e parë në këtë projekt përfshin mbeturinat e grumbulluara nga burime të ndryshme, të cilat mund të përfshijnë :

1. Letër,
2. Plastikë,
3. Metale të Aluminit,
4. Bateri dhe Vajra të Përdorura,
5. Makina jashtë përdorimit,
6. Bakër,
7. Çelik,
8. Dhe të tjera të paraqitura në kodet e mesiperme.

Grumbullimi i këtyre materialeve është faza e parë e procesit dhe ato përbëjnë lëndën e parë për fazat e mëtejshme të seleksionimit, presimit dhe ambalazhimit.

Lënda ndihmëse për këtë projekt përfshin materiale dhe burime që përdoren për të mbështetur procesin e operimit dhe për të siguruar efikasitetin dhe sigurinë gjatë përpunimit të mbetjeve. Këtu përfshihen:

1. Energjia elektrike
2. Uji nga ujësjellesi
3. Pajisje mbrojtëse – për punonjësit, si doreza, maska dhe veshje mbrojtëse që sigurojnë mbrojtjen gjatë operacioneve të përpunimit të mbeturinave.

Këto lëndë ndihmëse janë thelbësore për përmbushjen e kërkesave teknologjike dhe mjedisore të projektit, duke mundësuar përpunimin efikas dhe të sigurt të mbeturinave.

Qendra e grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit dhe magazinimit

A collage of various waste items including plastic bottles, cardboard boxes, and food waste, with a large green recycling symbol in the center.

Grumbullimi i Mbeturinave - Faza e parë e procesit është grumbullimi i mbeturinave nga burime të ndryshme, si institucione shëndetësore, fabrika, shtëpi dhe grumbullues të tjerë. Mbeturinat mblidhen me mjete të përshtatshme që sigurojnë ruajtjen e sigurt të materialeve dhe parandalimin e ndotjes gjatë transportit dhe grumbullimit. Përdorimi i kamionëve dhe mjeteve speciale mundëson menaxhimin efikas të materialeve të ndryshme dhe siguron që mbeturinat mbërrijnë në qendër për seleksionim pa ndodhur ndonjë ndotje e mundshme. Pas grumbullimit, mbeturinat dërgohen për seleksionim, ku ato ndahen sipas kategorive të materialeve të ndryshme, si letër, plastikë, metale dhe vajra të përdorura, për t'u trajtuar dhe përpunuar më tej.

 **Seleksionimi i Mbeturinave** - Seleksionimi është një hap i rëndësishëm për ndarjen e materialeve të ndryshme dhe përgatitjen e tyre për trajtim të mëtejshëm. Ky proces mund të realizohet manualisht ose me ndihmën e makinave automatike që mundësojnë ndarjen më efikase të materialeve të ndryshme. Mbeturinat e selektuara përfshijnë letër, plastikë, kanaçe alumini, bateri dhe vajra të përdorura, të cilat dërgohen për trajtim të mëtejshëm dhe përpunim. Kjo fazë është thelbësore, pasi ndarja e materialeve në

kategori të ndryshme kontribuon në përpunimin efikas dhe të sigurt të tyre në fazat pasuese dhe ndihmon në zvogëlimin e ndikimit të mbeturinave në mjedis.

✚ **Prerja e Mbeturinave të Plastikës dhe Letrës** - Pas seleksionimit, materialet e plastikës dhe letrës kalojnë përmes një procesi të përgatitjes për përpunim të mëtejshëm. Kjo përfshin prerjen e materialeve në dimensione të vogla, të cilat janë më të lehta për t'u menaxhuar dhe për t'u dërguar për përpunim. Pjesët e plastikës dhe letrës priten dhe shtrihen për të mundësuar kompresimin dhe ruajtjen më të lehtë të tyre. Ky proces bën të mundur kompresimin e materialeve dhe uljen e hapësirës që ato mbajnë, duke kontribuar në ruajtjen dhe menaxhimin efikas të tyre.

✚ **Presimi i Mbeturinave** - Pasi materialet janë selektuar dhe përgatitur, ato kalojnë në fazën e presimit. Ky proces është një hap kyç për të ulur volumet e mbeturinave dhe për të krijuar forma të kompjaktuara që janë më të lehta për transport dhe ruajtje. Përdorimi i makinerive presuese ndihmon në komprimimin e materialeve dhe zvogëlimin e hapësirës që ato mbajnë. Presimi ndihmon gjithashtu në ruajtjen e hapësirës magazinuese dhe mundëson një menaxhim më të lehtë dhe efikas të mbeturinave.

✚ **Lidhja e Mbeturinave** - Pasi materialet janë kompjaktuar, ato mund të kalojnë përmes një procesi të lidhjes për t'u siguruar që ato mbeten të sigurt gjatë transportit dhe ruajtjes. Ky proces mund të përfshijë përdorimin e linjave për lidhjen e materialeve të kompjaktuara, siç është përdorimi i lidhësve për të krijuar blloqe më të forta. Ky proces është i rëndësishëm për të ruajtur integritetin e materialeve dhe për të siguruar që ato janë të sigurt dhe të qëndrueshme gjatë fazave të mëtejshme të transportit dhe riciklimit.

✚ **Ruajtja dhe Transporti i Mbeturinave** - Mbeturinat e trajtuara ruhen dhe transportohen për trajtim të mëtejshëm në ambiente të siguruar. Pas trajtimit, materialet ruhen në depo të veçanta që janë të ndara sipas kategorive të materialeve të ndryshme. Magazinimi bëhet në kushte të sigurt, duke parandaluar ndotjen e mundshme të mjedisit dhe duke siguruar që materialet të ruajnë cilësinë e tyre. Ky proces mundëson menaxhimin e sigurt dhe efikas të mbeturinave deri në fazën e mëtejshme të përdorimit ose eliminimit.

✚ **Monitorimi dhe Kontrolli i Ndikimeve Mjedisore** - Në të gjithë këtë proces, kompania siguron një monitorim të vazhdueshëm të ndikimeve mjedisore, duke

përdorur sisteme të avancuara për të analizuar dhe kontrolluar ndotjen. Ky monitorim siguron që të gjitha fazat e procesit respektojnë standardet e mbrojtjes së mjedisit dhe

Procesi teknologjik i grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit dhe magazinimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura është i organizuar për të siguruar përpunim të qëndrueshëm dhe të sigurt të materialeve. Aktivitetet e kësaj qendre janë të dizajnuara për të zvogëluar ndikimet mjedisore dhe për të siguruar një menaxhim efikas të mbetjeve, përmes përdorimit të teknologjive moderne dhe metodave të qëndrueshme që respektojnë parimet e mbrojtjes së mjedisit.




Figura 4 Skemat e Procesit Teknologjik

Ne tabelën e mëposhtme do të paraqesim të gjitha llojet e kodeve që do përdoren dhe mënyrën e trajtimit.

Tabela 2. Llojet e kodeve dhe mënyra e trajtimit

Kodet e mbet.	Trajtimi i Mbeturisë
02 01 04	Mbeturinat nga plastika copëtohen dhe dërgohen tek kompanitë për riciklim
02 01 10	Mbeturinat metalike grumbullohen dhe seleksionohen
03 03 08	Mbeturinat nga klasifikimi i letres dhe kartonit të destinuara për riciklim
07 02 03*	Tretësira organike të halogjenuara, lëngjet për larje dhe lëngjet baze/ame, të cilat trajtohen përmes procesit të hollimit
07 02 13	Copëtohet dhe shitet tek kompanitë për riciklim
10 03 05	Ndarje fizike, seleksionohet alumini dhe shitet tek kompanitë e përpunimit
12 01 07*	Vajra minerale të makinerive që nuk përmbajnë halogjen, (përveç emulsioneve dhe solucionëve), grumbullohen në kazanë të inoksit dhe dërgohen tek kompanitë për riciklim
12 01 10*	Vajrat sintetike të makinave grumbullohen në kazanë të inoksit dhe dërgohen tek kompanitë për riciklim
13 01 01*	Vajrat hidraulike, që përmbajnë PCB, grumbullohen në kazanë të inoksit dhe dërgohen tek kompanitë për riciklim
15 01 01	Asgjësimit I ambalazhes së letres dhe kartonit, në disa raste kur letra dhe kartoni është I pastër ndahet dhe shitet tek kompanitë e riciklimit
15 01 02	Disa të dëmtuara asgjësohen, ndërsa plastika e pastër dorëzohet për riciklim tek kompanitë tjera
15 01 03	Grumbullim
15 01 04	Ndarje fizike dhe copitim
15 01 05	Grumbullim
15 01 06	Klasifikohen ku disa prej tyre asgjësohen dhe disa copëtohen
15 01 07	Grumbullohet, klasifikohet dhe dërgohet tek qendrat e grumbullimit të metaleve për përpunim të mëtejme
15 01 09	Grumbullim
15 02 02*	Grumbullim, trajtim fizik pastaj dërgohen tek kompanitë për riciklim
16 01 03	Copëtohen dhe dërgohen tek kompanitë për ripërdorim
16 01 04*	Ndarje fizike dhe Copëtohen dhe dërgohen tek kompanitë për ripërdorim
16 01 06	Automjetet jashtë përdorimit që nuk përmbajnë lëngje apo komponentë tjera të rrezikshme, Ndarje fizike dhe copitim
16 01 07*	Filtra vaji, grumbullohen në kazanë të inoksit dhe dërgohen tek kompanitë për riciklim
16 01 09*	Komponentët që përmbajnë PCBs, Grumbullohet, klasifikohet dhe dërgohet tek qendrat e grumbullimit të metaleve për përpunim të mëtejme
16 01 17	Grumbullohet, klasifikohet dhe dërgohet tek qendrat e grumbullimit të metaleve për përpunim të mëtejme
16 02 15*	Dërgohen tek kompanitë e licencuara për asgjësimit
16 01 18	Grumbullohet, klasifikohet dhe dërgohet tek qendrat e grumbullimit të metaleve për përpunim të mëtejme
16 01 19	Mbeturinat nga plastika copëtohen dhe dërgohen tek kompanitë për riciklim
16 01 20	Grumbullohet dhe dërgohet tek kompanitë e riciklimit
16 02 14	Grumbullohen

16 02 16	Grumbullohen
16 06 01*	Copëtohen, klasifikohen plumbi ndahet dhe shitet tek kompanitë e përpunimit te mëtejme ndërsa plastika asgjësohet
16 06 02*	Copëtohen, klasifikohen plumbi ndahet dhe shitet tek kompanitë e përpunimit te mëtejme
16 06 03*	Copëtohen, klasifikohen plumbi ndahet dhe shitet tek kompanitë e përpunimit te mëtejme
16 06 04	Copëtohen, klasifikohen plumbi ndahet dhe shitet tek kompanitë e përpunimit te mëtejme ndërsa plastika asgjësohet
16 06 05	Copëtohen, klasifikohen plumbi ndahet dhe shitet tek kompanitë e përpunimit te mëtejme ndërsa plastika asgjësohet
16 06 06*	Grumbullim, trajtim fizik
16 07 08*	Grumbullohen, behet ndarja fizike dhe vajrat trajtohen ne seperator te vajrave , pastaj dorëzohen tek kompanitë e riciklimit
16 08 01	Ndahen fizikisht dhe shiten tek kompanitë e riciklimit ne Kosovë
16 08 02*	Grumbullim, trajtim fizik
16 08 03	Grumbullim, trajtim fizik
17 02 01	grumbullohet
17 02 02	Grumbullohet dhe dërgohet tek kompanitë e riciklimit
17 02 03	Grumbullohet, seleksionohet dhe copëtohet dhe pastaj dërgohet tek kompanitë riciklimit
17 04 01	Grumbullohen ndahen fizikisht dhe pastaj dërgohen tek qendrat e grumbullimit te metaleve
17 04 02	Grumbullohen ndahen fizikisht dhe pastaj dërgohen tek qendrat e grumbullimit te metaleve
17 04 03	Grumbullohen ndahen fizikisht dhe pastaj dërgohen tek qendrat e grumbullimit te metaleve
17 04 04	Grumbullet dhe shitet
17 04 05	Grumbullohen ndahen fizikisht dhe pastaj dërgohen tek qendrat e grumbullimit te metaleve
17 04 06	Grumbullohen ndahen fizikisht dhe pastaj dërgohen tek qendrat e grumbullimit te metaleve
17 04 07	Grumbullohen ndahen fizikisht dhe pastaj dërgohen tek qendrat e grumbullimit te metaleve
19 12 01	Grumbullim, trajtim fizik dhe pastaj dërgon tek qendrat për riciklim
19 12 02	Grumbullohen ndahen fizikisht dhe pastaj dërgohen tek qendrat e grumbullimit te metaleve
19 12 03	Grumbullohen ndahen fizikisht dhe pastaj dërgohen tek qendrat e grumbullimit te metaleve
19 12 04	Grumbullohet, seleksionohet dhe copëtohet dhe pastaj dërgohet tek kompanitë riciklimit
19 12 05	Grumbullohet dhe dërgohet tek kompanitë e riciklimit
19 12 07	Grumbullim
19 12 08	Grumbullim, dorëzim tek kompanitë e riciklimit
19 12 12	Grumbullim, trajtim fizik
20 01 01	Grumbullim, trajtim fizik, kompaksim dhe shitet tek kompanitë e riciklimit
20 01 02	Grumbullohet dhe dërgohet tek kompanitë e riciklimit
20 01 10	Grumbullim, dorëzim tek kompanitë e riciklimit

20 01 11	Grumbullim, dorëzim tek kompanitë e riciklimit
20 01 25	Grumbullim, dorëzim tek kompanitë e riciklimit
20 01 33*	Grumbullohen ndahen fizikisht dhe pastaj dërgohen tek qendrat e grumbullimit te metaleve
20 01 34	Grumbullohen ndahen fizikisht dhe pastaj dërgohen tek qendrat e grumbullimit te metaleve
20 01 35*	Grumbullim, ndarja fizike
20 01 36	Grumbullim, ndarja fizike
20 01 38	Grumbullim
20 01 39	Grumbullohet, seleksionohet dhe copëtohet dhe pastaj dërgohet tek kompanitë riciklimit
20 01 40	Grumbullohen ndahen fizikisht dhe pastaj dërgohen tek qendrat e grumbullimit te metaleve
20 03 01	Grumbullim, ndarja fizike

f) Përlllogaritja sipas llojit dhe sasisë të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjatë fazës së operimit

Përlllogaritja e sasisë së mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjatë fazës së operimit të qendrës për grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit dhe magazinimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura nga “EURO STEEL”SH.P.K. është një proces i rëndësishëm për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve dhe për vlerësimin e ndikimeve mjedisore. Kjo përlllogaritje do të ndihmojë në përcaktimin e volumit të mbetjeve dhe emetimeve që do të gjenerohen, si dhe në hartimin e strategjive për uljen e ndikimeve mjedisore. Përlllogaritja e sasisë së mbetjeve që do të grumbullohen, seleksionohen dhe përpunohen në impiantin mund të bazohet në përlllogaritet në bazë të përqindjes së materialeve të ndryshme (letër, plastikë, kanaqe alumini, makina të vjetra, bateri, vjra të përdorura) që do të mblidhen gjatë periudhës së operimit. Mund të përdoren të dhëna të njohura nga industria ose të dhëna historike për sasinë e mbetjeve që grumbullohen në një periudhë të caktuar kohe. Çdo kategori materiali ka një përqindje të caktuar që do të trajtohet, në varësi të teknologjisë dhe metodave që përdoren.

Ajër: Faza operative e qendrës për grumbullimin, transportimin, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit dhe magazinimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura mund të shkaktojë emetime në ajër për shkak të proceseve si transporti, përdorimi i makinerive industriale dhe presimi i materialeve. Emisionet kryesore përfshijnë dioksidin e karbonit (CO₂), oksidet e azotit (NO_x), pluhurin. Transporti i mbetjeve dhe përdorimi i makinerive përpunuese janë burimet kryesore të ndotjes. Lëshimi i pluhurit janë gjithashtu shqetësime për cilësinë e ajrit. Për të reduktuar ndikimet, është e nevojshme të

përdoren teknologji efikase dhe masat për kontrollin e emetimeve. Monitorimi dhe menaxhimi i duhur do të ndihmojnë në mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik.

Ujë: Faza operative e qendrës për grumbullimin, transportimin, trajtimin fizik, ripërdorimit, përpunimit dhe magazinimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura mund të ndikojë në cilësinë e ujit përmes mundësisë së derdhjes së substancave të dëmshme si vajra, kimikate dhe materialeve të tjera që mund të depërtojnë në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore. Masat për minimizimin e ndikimeve përfshijnë përdorimin e mbrojtjes për të parandaluar derdhjen, si dhe implementimin e sistemeve për trajtimin e ujit të përdorur dhe ruajtjen e kushteve higjienike gjatë operacioneve.

Dheu: Gjatë fazës operative të qendrës për grumbullimin, transportimin, trajtimin fizik, ripërdorimit, përpunimit dhe magazinimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura, ndikimet në tokë mund të ndodhin si rezultat i derdhjes së substancave të dëmshme si vajra, kimikate dhe materialeve të tjera nga mbeturinat. Këto substanca mund të depërtojnë në tokë, duke shkaktuar ndotje dhe dëm të mundshëm për strukturën e saj dhe për produktet bujqësore që mund të rriten aty. Po ashtu, procesi i pastrimit dhe lëvizjes së mbeturinave mund të shkaktojë ndotje të tokës, duke ndikuar në biodiversitetin dhe stabilitetin e ekosistemit.

Zhurma: gjate ndertimit mund te ketë zhurmë gjate lëvizjes se makinerive e cila është e pranueshme sipas normave, po ashtu edhe gjate operimit është minimale.

Flora dhe Fauna: Në rast se kemi derdhje apo shkarkim nga ky aktivitet në aspektin e ndikimeve fizike në florë dhe faunë është minimal. Ndikimet në florë dhe faunë janë minimale.

Ndikimet sociale dhe ekonomike: mund te themi lirisht se ky aktivitet nuk do të paraqes ndonjë ndikim negativ në komunitetin lokal.

4. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TE ARSYESHME

Duke e pasur parasysh se hapësira ku do të ndërtohet qendra e grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit dhe magazinimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura “EURO STEEL” SH.P.K. është përzgjedhur në atë mënyrë që të jetë sa me afër lëvizjeve të shumta të makinerive dhe po ashtu të ruaj shëndetin e njeriut.

Me poshtë do ti paraqesim disa alternativa të arsyeshme për të minimizuar ndikimet negative në mjedis dhe shoqëri:

- **Zgjedhja e Zonave:** Zgjedhja e lokacioni është bërë në zonë me infrastrukturë të zhvilluar, ku është e mundur të lidhet lehtësisht me burime të tjera si energjia dhe uji.

Përparësitë:

- Këto zona zakonisht ofrojnë rrjete të mira transporti, të cilat janë thelbësore për transportin e lëndëve të para dhe shpërndarjen e produkteve.
- Këto zona shpesh kanë afërsi me burime të tjera si energjia dhe uji. Kjo është e rëndësishme për funksionimin e pandërprerë të proceseve të grumbullimit dhe përpunimit të mbeturinave.

Mangësitë:

- Aktivitetet industriale të tjera në zonë mund të rrisin ndotjen e ajrit dhe ujit, duke ndikuar në cilësinë e produktit.
- Nëse ka shumë fabrika të tjera që operojnë në të njëjtën zonë, mund të krijohet një konkurrencë e madhe që do të vështirësojë mbajtjen e çmimeve konkurruese dhe rritjen e kapaciteteve të fabrikës.

- **Qasja e Mirë:** Lokacioni në Ramun ofron qasje të shkëlqyer në rrugët dhe infrastrukturën e transportit, një faktor kyç për një operacion efikas të qendrës.

Përparësitë:

- Qasja në rrugët kryesore mund të zvogëlojë kostot e transportit të materialeve dhe shpërndarjen e produkteve. Kjo është e rëndësishme për një qendër që merret me grumbullimin dhe shpërndarjen e mbeturinave dhe produkteve të tjera.
- Lehtësitë për transportin e shpejtë dhe të sigurt mes impiantit dhe tregjeve ndihmojnë për të rritur efikasitetin dhe shërbimin ndaj klientëve.

Mangësitë:

- Në periudha të pikut, rrugët mund të jenë të ngarkuara, duke shkaktuar vonesa dhe ndikime negative në operacionet e ditore. Kjo mund të dëmtojë efikasitetin dhe mund të rrisë kostot operative.
- Rritja e aktivitetit industrial në zonë mund të kërkojë investime të mëtijshme për menaxhimin e trafikut dhe sigurimin e sigurisë, si dhe për të ruajtur fluksin normal të operacioneve.

➤ **Burime Të Tjera:** Lokacioni ofron akses të lehtë në burime të tjera si energjia elektrike dhe ujë, që janë të domosdoshme për funksionimin e qendrës së grumbullimit të mbeturinave.

Përparësitë:

- Prania e burimeve të energjisë afër mund të sjellë kosto më të ulëta operative dhe një furnizim të qëndrueshëm energjie për qendrën e grumbullimit të mbeturinave. Ky furnizim i vazhdueshëm është thelbësor për proceset e përpunimit të mbeturinave.

Mangësitë:

- Çdo problem me furnizimin e energjisë mund të ndikojë drejtpërdrejt në operacionet e qendrës së grumbullimit të mbeturinave, duke sjellë vonesa dhe humbje financiare. Ajo mund të kërkojë një investim të madh për përmirësimin e infrastrukturës energjetike, nëse burimet nuk janë të zhvilluara mjaftueshëm.
- Nëse burimet aktuale nuk janë të mjaftueshme ose nuk janë zhvilluar mirë, mund të kërkojë investim shtesë për të siguruar furnizim të qëndrueshëm dhe efikas.

Duke marrë parasysh këto alternativa të arsyeshme dhe duke vlerësuar tërësisht secilën prej tyre, kompania “EURO STEEL” SH.P.K. nuk e ka pasur të vështirë të merr një vendim të informuar për vendndodhjen më të përshtatshme për qendrën e grumbullimit, selesksionimit, presimit dhe ambalazhimit të mbeturinave të letrës, plastikës, kanaçeve të aluminit, maskinave të vjetra, baterive dhe vajrave të përdorura. Kompania e ka parë të rëndësishme dhe ka angazhuar ekspertë të cilët kanë kryer studime gjithëpërfshirëse të fizibilitetit për të zgjedhur lokacionin që përputhet më mirë me qëllimet dhe vlerat e biznesit të kompanisë “EURO STEEL” SH.P.K. Andaj duke i marre parasysh të gjitha alternativat e mësipërme është përzgjedhur lokacioni i kompanisë “EURO STEEL” SH.P.K., e cila ka qasje në rrugën, ka energjinë elektrike afër po ashtu ka edhe ujera nëntokësorë në sasi të mjaftueshme.

5. GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT

Gjendja e mjedisit në komunën e Pejës nuk është e mirë. Degradimi i tij është rezultat i ndërtimeve të pakontrolluara në zonat e mbrojtura të natyrës ashtu edhe jashtë tyre, infrastrukturës jo adekuate, shtimit të numrit të automjeteve dhe importimit të mjeteve motorike të vjetruara në Kosovë, importi i vajrave dhe derivateve të kualitetit të dobët (me sasi të lart të sulfurit), deponimi i joadekuat i tyre, ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga mungesa e trajtimit të ujërave të zeza, prerjes së pakontrolluar të pyjeve, akumulimit të plehrave urbane si pasojë e mos menaxhimit të mirë, mungesës së riciklimit dhe trajtimit të ujërave të zeza. Për më tepër, degradimi ndodhë edhe nga mihjet sipërfaqësore dhe eksploatimi i zhavorrit nga një numër i konsideruar i kompanive. Gjithashtu edhe sektori i transportit është një ndër sektorët që ka ndikim mjaft negativ në gjendjen e mjedisit dhe në cilësinë e përbërësve të tij (ajrin, ujin dhe tokën). Ai po ashtu ndikon edhe në fragmentimin dhe degradimin e habitateve, ndryshimin e peizazhit, destinimin e shfrytëzimit të tokës dhe trashëgiminë kulturore. Kjo gjendje e kërcënon mjedisin duke shkaktuar ndotjen e ujit, ujërave nëntokësore, ajrit dhe dheut dhe si pasojë shkakton dëmtim të resurseve natyror dhe humbje të tokës bujqësore.

5.1. Flora dhe Fauna

Gjendja e florës dhe faunës nuk është e kënaqshme, shkaktarë të kësaj gjendje janë: gjuetia e paligjshme dhe pa kriter, përndjekja dhe kapja e kafshëve me qëllim tregtie, shqetësimi i vazhdueshëm nga ana e njeriut, peshkimi i paligjshëm, prerja, djegia dhe dëmtimi i pyjeve, shkatërrimi i habitateve natyrore, ndikimi i urbanizmit, transportit dhe turizmit, etj. Zhvillimi veprimtarive të shumta dhe të ndryshme në natyrë, siç janë: ndërtimi i vendbanimeve, zhvillimi i turizmit malorë, prerja e pyjeve, gurthyesit etj., shpeshherë janë bërë pa një kriter të qëndrueshëm për ruajtjen e natyrës. Ky shfrytëzim i natyrës dhe i vlerave të saja ka atakuar ekosistemet dhe diversitetin biologjik në masë të konsiderueshme. Biodiversiteti - Komuna e Pejës, shquhet për shumëllojshmëri biologjike dhe të peizazhit. Zona e Bjeshkëve të Nemuna me relievin e thyer, burimet, ujëvarat dhe shpellat, strehon një shumëllojshmëri të habitateve dhe vegjetacionit, duke përfshirë specie endemike, sub endemike dhe relikte të bimëve. Krahas me pyjet e ahut dhe të lisit, Bjeshkët e Nemuna janë të pasura me pyje të gështenjës dhe pishave me karakter relikte dhe endemik - munika (*Pinus Leucodermis*), molika (*Pinus Peuce*), pisha e bardhë dhe e zezë (*Pinus silvestris et nigra*), etj. Në Majen e Rusolisë rritet bima luleylli (*Lentopodium alpinum*), kurse në Gubavc forzitia (*Forsytia europea*). Edhe fauna është

jashtëzakonisht e pasur e përfaqësuar nga: rrëqebulli (*Lynx lynx*), ariu i murrmë (*Ursus arctos*), kaprolli (*Capreolus capreolus*), dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*), shqiponja e maleve (*Aquila chrysaetos*), fajkoi thonj bardhë (*Falco naummani*), pulegra (*Tetrao urogallus*), etj. Lumenjtë janë të pasur me peshq veçanërisht me troftë. Gjithashtu janë prezentë edhe shumë lloje të ujëtokësorëve, reptilëve dhe zvarranikëve. Dallohen breshka e pyllit dhe e kënetave, bretkosat, hardhucat dhe gjarpërinjtë. Në Bjeshkët e Nemuna jetojnë edhe 129 lloje fluturash nga rendi Lepidoptera që e bëjnë rajonin ndër më të pasurit në Evropë për çka është identifikuar edhe si PBA (Primary Butterfly Area). Për shkak të pasurisë së madhe me shpendë, si dhe kalimit të rrugëve migratore nëpër zonë, Bjeshkët e Nemuna janë konstatuar edhe si IBA rajone (IBA-Important Bird Areas)

5.2 Hidrografia

Hidrografia - Rrafshi i Dukagjinit konsiderohet si treva më e pasur në Kosovë me resurse ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore. Komuna e Pejës ka një rrjet të zhvilluar hidrografik si lumenj, përroska, puse, liqene, burime. Duke marrë parasysh që ato mbushen nga reshjet e shiut dhe borës, sasia më e madhe e rrjedhave ujore është në vjeshtën e vonë dhe në pranverë.




Figura 5. Rrjeti Hidrografik ne K. Pejës

Lumbardhi i Pejës buron në Bjeshkët e Nemuna në më se 1.900 metra lartësi mbidetare. Në rrjedhën e vet të epërme, në Grykën e Rugovës ai është lum malor me një numër të madh kaskadash dhe rrymash të shpejta. Në rrjedhën e tij të poshtme, në drejtim të Rrafshit të Dukagjinit, Lumbardhi rrjedh qetë duke krijuar shtratin e vet, i cili në disa vende arrin gjerësi

deri në 200 m, dhe në Grabanicë derdhet në Drinin e Bardhë. Lumbardhi mbledh disa burime përgjatë Grykës së Rugovës si: Lumin e Boges në anën e majtë të tij dhe Lumin e Allagës në derdhjen e së cilit në Lumbardh ka kushte për ndërtimin e një akumulacioni relativisht të madh të ujit. Sipërfaqja ujëmbledhëse e Lumbardhit të Pejës është 464.8 km², me një gjatësi prej 57km, ndërsa prurja mesatare e ujit është 10,22 m³/sek. Drini i Bardhë është një nga lumenjtë më të mëdhenj, dhe ujëmbledhësi kryesor hidrografik i rrafshit të Dukagjinit, me sipërfaqe prej 4340 km², gjatësi prej 110.7 km dhe prurje mesatare të ujit 61.7 m³ /s. Buron afër fshatit Radavc, rrëzë maleve të Zhlebit, në një lartësi mbidetare prej afër 580 metrash. Në dalje të burimit lumi krijon ujëvarë, e pastaj me zbritje relativisht të vogël, rrjedhë në një gjatësi prej afër 110 kilometrash deri në daljen e tij në Shqipëri. Sipas Master Planit për Ujëra e Kosovës 1983-2000, potencialet më të mëdha të ujërave nëntokësore gjinden në rrafshin e Dukagjinit dhe shfrytëzimi i tyre bëhet kryesisht përmes puseve dhe burimeve të cilat edhe në Komunën e Pejës janë të shumtë. Në zonën e Rugovës gjenden edhe liqenet glaciale si ai i Kuqishtës (1900 m), Liqeni i Drelajve (1800m), dhe 2 liqenet në Leqinat në lartësi prej 1860 m që shquhen për bukurinë e tyre dhe rrethinën e mbuluar me pyje të dendura pishë.

5.3 Ndotësit Kryesorë

Përdorimi i drurit për ngrohje është njëri nga kontribuesit më të mëdhenjë të ndotjes së ajrit dhe burimi kryesor i pluhurit grimcor. Ndotësit më të mëdhenjë nga zjarri i drurit janë pluhuri grimcor, karboni i zi, hidrokarbonet poli-aromatike dhe dioksinat. Përveç tjerash, zjarri nga druri shkakton edhe oksidet e azotit dhe monoksidin e karbonit. Në Kosovë zjarri nga druri që përdoret kryesisht në sektorin e banimit përbën rreth 20% të konsumit të përgjithshëm të energjisë. Bazuar në përllogaritjet e GAINS, sektori i banimit përbën gati gjysmën e emetime të pluhurit grimcor PM_{2.5} dhe pothuajse 80% të emetimeve të karbonit të zi për vitin 2015.

Komuna e Pejës, një pjesë e qytetit posedon sistem të ngrohjes qendrore, ndërsa shumica dërmuese e banorëve shfrytëzon drurin si burim të vetëm për ngrohje duke shkaktuar ndotje të konsiderueshme të ajrit, në veçanti gjatë periudhës së dimrit. Në masë më të vogël përdoret thëngjilli, nafta dhe gazi natyror.

5.4 Transporti rrugor

Transporti është përgjegjës për më shumë se dy të tretat e emetimit të oksideve të azotit (NO_x) dhe me përreth 10% të emetimit të përgjithshëm të ndotësve tjerë. Transporti rrugor në veçanti vazhdon të përbëj pjesën më të konsiderueshme të ndotësve kryesorë të ajrit (me përjashtim të oksideve të sulfurit). Përderisa emetimet nga transporti rrugor janë kryesisht lirime të gazrave

5.5 Mbeturinat e ngurta

Mbeturint komunale permbajne nje game te gjere te ndotesve, perfshire metalet e rënda, cianidin (CN), Hidrokarburet policiklike, bifenilet e polikloruara, azbestin, metanin, amoniakun dhe hidrogjen sulfidet të cilat kanosin tokat përreth. Klasifikimi i mbeturinave bëhet sipas Ligjit nr. 04/L-060 për mbeturina dhe ndahen në mbeturina komunale, komerciale, industriale dhe medicinale. Ndersa sipas nivelit te rrezikshmerise ndahen ne mbeturina Inerte, te parrezikshme, dhe të rrezikshme. Mbeturinat Komunale të Pejës deponohen në deponinë regjionale në Pejë, e cila menaxhohet nga Kompania Rajonale për Mbeturina K.R.M Ambienti SH.A.

5.6 Ndotësit nga burimet agro-kemikale

Ndotësit nga burimet agro-kemikale përfshijnë fertilizuesit, plehun organik dhe pesticidet. Efektet ndotëse më të mëdha nga fertilizuesit dhe plehu organik konsiderohen të jenë futja e metaleve të rënda dhe komponimeve të tyre në dhe.

6. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

Ky raport ka për qëllim të prezantojë një analizë të ndikimeve të mundshme në mjedis që mund të lindin nga aktivitetet industriale të planifikuara për ndërtimin e kompanisë “EURO STEEL” SH.P.K., duke u fokusuar në masat zbutëse që do të merren për të minimizuar ndikimet negative në mjedis. Analiza e ndikimeve në mjedis do të realizohet në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, duke u siguruar që aktivitetet industriale të mos shkaktojnë dëme të mëdha në mjedisin natyror, biodiversitetin, dhe aspektet socio-ekonomike të zonës.

Analiza e VNM-së në këtë rast realizohet duke u bazuar në projektin e përfunduar më lart në këtë raport si dhe nga gjendja reale në lokacionin respektivisht zonën ku është ndërtuar objekti të cilin e shfrytëzon kompania “EURO STEEL” SH.P.K. Kjo analizë kryhet me qëllim të vlerësimit të ndikimit në mjedis në dobi të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit duke mos i cenuar aspektet: kimike-fizike (ndikimet në burimet natyrore dhe degradimi fizik i mjedisit), biologjike-ekologjike (ruajtja e biodiversitetit, ndikimi mbi jetën e gjallë dhe biosferë) dhe socio-ekonomike (ndikimet e përkohshme apo të përhershme pozitive apo negative).

6.1. Ndikimet në ajër

Ndikimet në ajër gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit të një objekti industrial si ai i kompanisë "EURO STEEL" SH.P.K. mund të ndodhin për shkak të aktiviteteve të ndryshme që lidhen me ndërtimin dhe funksionimin e objektit. Këto ndikime përfshijnë emetimin e pluhurit, gazrave dhe substancave të tjera të ndotura që mund të ndikojnë në cilësinë e ajrit dhe shëndetin e njerëzve dhe ekosistemit përreth.

 **Ndikimet në ajër gjatë fazës së ndërtimit** - Faza e ndërtimit është një periudhë me aktivitete intensive që mund të shkaktojnë ndotje të ajrit. Aktivitetet e ndërtimit, si gërmimi, shtrimi i bazave, ndihmesat mekanike dhe përdorimi i materialeve të ndërtimit (çimento, dhe, lëndë të tjera) mund të shkaktojnë shpërndarje pluhuri në ajër. Ky pluhur mund të përmbajë substanca të ndryshme. Makinat dhe pajisjet e përdorura gjatë ndërtimit (si buldozerët, ekskavatorët, kamionët) përdorin karburant fosil dhe mund të lëshojnë gazra të ndotur, si dioksid karboni (CO₂), okside azoti (NO_x), dhe pluhur.

Ndikimet në ajër gjatë fazës së operimit - Faza e operimit të kompanisë “EURO STEEL” SH.P.K., e cila përfshin grumbullimin, transportimin, trajtimin fizik, ripërdorimit, përpunimit dhe magazinimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura, mund të shkaktojë ndikime të tjera në cilësinë e ajrit. Aktivitetet e përpunimit të

materialeve të riciklueshme si plastika, letër, metale dhe qelq mund të shkaktojnë shpërndarjen e pluhurit dhe pjesëzave të imta. Gjatë përpunimit të materialeve organike dhe plastikës, mund të lirohen substanca organike të pa stabilizuara, të cilat mund të ndikojnë në cilësinë e ajrit dhe të shkaktojnë aromë të keqe dhe ndotje të ajrit. Gjatë seleksionimit, krijohet pluhur nga materialet si plastika dhe letër, i cili mund të përmbajë substanca të dëmshme, të cilat ndotin ajrin dhe përbëjnë një rrezik për shëndetin e punonjësve dhe të komunitetit përreth. Po ashtu, materialet e përziara mund të lëshojnë gaze të dëmshme, si substanca organike të paqëndrueshme (VOCs). Në fazën e presimit, ku materialet kompresohen për t’u përgatitur për transport ose depozitimin më tej, lëshimi i gazrave si dioksina mund të ndodhë, veçanërisht kur plastikat ose metale të tjera përpunohen nën presion të lartë. Ambalazhimi i materialeve të grumbulluara dhe të selektuara gjithashtu mund të shkaktojë lëshime të gazrave dhe pluhurit. Plastikët dhe metale të tjerë mund të lëshojnë gaze të paqëndrueshme gjatë manipulimit, duke përkeqësuar cilësinë e ajrit dhe duke shkaktuar ndotje. Një tjetër komponent i rëndësishëm i procesit është trajtimi i makinave të vjetra, baterive të përdorura dhe vajrave të konsumuar. Makineritë dhe bateritë mund të përmbajnë substanca të rrezikshme si plumb, kadmium, acid, dhe metale të tjera të rënda, të cilat mund të ndotin ajrin kur trajtohen ose grumbullohen pa masa të duhur. Vajrat e përdorura gjithashtu përmbajnë substanca kimike që mund të lëshojnë gaze të dëmshme dhe të kontribuojnë në ndotjen e ajrit gjatë trajtimit.

6.2. Ndikimet në tokë

Ndikimet në tokë gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit të një objekti industrial, si ai i kompanisë “EURO STEEL” SH.P.K., mund të ndodhin për shkak të aktiviteteve të ndryshme të ndërmarrë gjatë këtyre fazave. Këto ndikime mund të përfshijnë ndryshime në strukturën e tokës, ndotje, degradim të saj dhe ndikime negative të tjera në ekosistemet përreth.

- ✚ **Ndikimet në tokë gjatë fazës së ndërtimit** - Faza e ndërtimit është një periudhë intensive aktivitetesth që mund të shkaktojë ndikime të ndryshme në tokë. Gjatë ndërtimit, aktivitetet si gërmimi, grumbullimi i materialeve të ndërtimit dhe përdorimi i makinerive të mëdha mund të shkaktojë komprimimin e tokës. Komprimimi i tokës mund të çojë në humbjen e kapacitetit të saj për t’u shkrirë dhe ruajtur ujërat, duke zvogëluar aftësinë e saj për të mbajtur ekosistemet dhe bimët që mbështeten në të. Gjatë procesit të ndërtimit, mund të shkatërrohen shtresa të tokës dhe bimësi natyrore, si barishte, shkurre dhe pemë, që mund të çojnë në humbjen e biodiversitetit dhe zvogëlimin e burimeve natyrore që mbështesin jetën e egër. Aktivitetet e ndërtimit

mund të çojnë në shpërndarjen e materialeve të ndryshme ndotëse, si pluhur, beton, mbeturina ndërtimi, që mund të ngelën në tokë dhe të krijojnë një ndotje të vazhdueshme.

✚ **Ndikimet në tokë gjatë fazës së operimit** - Në fazën e operimit, kur kompania "EURO STEEL" SH.P.K. është aktive në grumbullimin, seleksionimin, përpunimin dhe magazinim të mbeturinave, ndikimet në tokë mund të vijnë si rezultat i aktiviteteve të përpunimit industrial dhe ruajtjes së mbetjeve. Nëse mbeturinat e grumbulluara dhe të trajtuara nuk menaxhohen siç duhet, ato mund të shkaktojnë ndotje të tokës. Përdorimi i magazinave dhe depozitave të pasigurta mund të çojë në shpërndarjen e substancave ndotëse që mund të dëmtojnë tokën dhe ekosistemet përreth. Mbajtja e materialeve të riciklueshme në kushte jo të përshtatshme mund të shkaktojë ndotje kimike dhe të prishë strukturën e tokës. Nëse mbeturinat, veçanërisht ato kimike, nuk depozitohen dhe ruhet në mënyrë të sigurt, mund të ndodhin rrjedhje të substancave të dëmshme që do të ndikojnë negativisht në tokë dhe ujë. Ky është një rrezik për burimet natyrore dhe mund të ketë pasoja të rënda për shëndetin e ekosistemit.

6.3. Ndikimet në ujë

Ndikimet në ujë gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit të një objekti industrial, si ai i kompanisë “EURO STEEL” SH.P.K., mund të ndodhin si pasojë e aktiviteteve të ndryshme që zhvillohen në këto faza. Këto ndikime mund të përfshijnë ndotjen e burimeve ujore, ndryshime në cilësinë e ujit dhe rrezikun e ndotjes së ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë. Më poshtë janë disa ndikime të mundshme në ujë gjatë këtyre dy fazave:

- ✚ **Ndikimet në ujë gjatë fazës së ndërtimit** - Gjatë fazës së ndërtimit, ndërhyrjet në tokë dhe aktivitetet e përfshira mund të çojnë në ndikime të rëndësishme në cilësinë dhe ruajtjen e burimeve ujore. Aktivitetet e ndërtimit si gërmimi, përpunimi i materialeve dhe përdorimi i makinerive të mëdha mund të çojnë në përhapjen e pluhurit dhe grimcave të tjera që mund të ndotin ujërat sipërfaqësorë. Mbeturinat ndërtimore, si pluhur, materialet e mbetura ose mbetje të tjera, mund të përfundojnë në tokë dhe mund të ndotin burimet ujore që mund të jenë pranë zonës.
- **Ndikimet në ujë gjatë fazës së operimit** - Gjatë fazës së operimit, kur kompania “EURO STEEL” SH.P.K. është aktive në grumbullimin, transportimin, trajtimin fizik, ripërdorimit, përpunimit dhe magazinimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave

metalike dhe vajrave të përdorura, ndikimet në ujë mund të vijnë si rezultat i aktiviteteve industriale dhe menaxhimit të mbeturinave. Nëse mbeturinat e mbledhura nuk trajtohen dhe depozitohen siç duhet, ato mund të shpërndahen në rrjedhat ujore dhe të ndikojnë në cilësinë e ujit. Përsëri, kjo mund të përfshijë mbeturina të ndotura, si pluhur, mbetje metalike ose materiale të tjera që mund të ndikojnë negativisht në ujërat që përdoren nga ekosistemet ujore dhe nga njerëzit. Vajrat e përdorura nga makineritë dhe pajisjet, të cilat përmbajnë hidrokarbure dhe metale të rënda, mund të shkaktojnë ndotje të ujit dhe të dëmtojnë ekosistemet ujore nëse nuk trajtohen si duhet. Vajrat dhe derivatet nëse derdhen në tokë nga makinat transportuese që transportojnë mbeturinat mund të ndikojnë në ndotjen e ujërave sipërfaqësorë, sidomos gjatë reshjeve atmosferike. Këto substanca mund të shpërndahen përmes rrjedhës së ujit dhe të arrijnë në lumenj, liqene, dhe në burime të tjera të ujërave

6.4. Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë

Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë nga aktivitetet e kompanisë "EURO STEEL" SH.P.K. mund të jenë të ndryshme, në varësi të fazës së ndërtimit dhe operimit të depozës, si dhe karakteristikave të zonës ku është vendosur. Për një depo të vogël, ndikimet mund të jenë më të kufizuara, por gjithsesi duhet të merren parasysh efektet e mundshme që mund të kenë këto aktivitete në mjedis. Gjatë ndërtimit, mund të ketë ndryshime të përkohshme në peizazhin përreth. Kjo mund të ndodhi për shkak të gërmimeve, ndërtimit të infrastrukturës, dhe instalimit të pajisjeve të nevojshme për operim. Gjatë procesit të ndërtimit, mund të ketë shkatërrim të habitateve natyrore për bimët e zonës. Kjo mund të çojë në humbjen e llojeve të bimëve të natyrshme, veçanërisht nëse ndodhin prerje drurësh ose pastrim i shkurreve dhe vegjetacionit natyror. Ndikimet e mundshme të ndotjes nga proceset industriale, si ndotja ajrore nga pluhuri mund të ndikojnë në shëndetin e bimëve të afërta. Pluhuri, substancat e tjera ndotëse mund të zvogëlojnë cilësinë e ajrit dhe tokës, duke ndikuar në rritjen dhe zhvillimin e bimëve. Ndryshimet në peizazh mund të krijojnë kushte që lehtësojnë shfaqjen e specieve invazive, të cilat mund të zëvendësojnë dhe rrezikojnë speciet lokale. Shkatërrimi i habitatit natyror ndikon direkt në faunën lokale, duke shkaktuar rënie në numrin e disa specieve, veçanërisht ato që janë të ndjeshme ndaj ndryshimeve mjedisore. Ndotja e ajrit, ujit dhe tokës nga aktivitetet e fabrikës mund të ketë efekte të dëmshme në shëndetin e kafshëve dhe të ndikojë në popullatat e tyre.

6.5. Ndikimet në vendbanime dhe popullatë

Hapësira ku do të ndërtohet objekti të cilin e shfrytëzon kompania “EURO STEEL” SH.P.K. nuk ka ndikim negative në popullatën e zonës pasi që lokacioni ku është bërë ndërtimi është zone industriale dhe larg vendbanimeve. Qendra ka ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik të zonës dhe ndihmon në mbështetje përmes punësimit të komunitetit lokal.

6.6. Ndikimet nga zhurma

“EURO STEEL” SH.P.K. zona kadastrale Ramun, Komuna e Pejës, qendra e mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit dhe magazinimit, të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura në domenin e mbrojtjes së mjedisit, ku zhurma paraqet një faktor me rëndësi hapësinore e cila ka ndikim të madh në dëmtimin e të dëgjuarit, në sistemin e nervor, në hipertension, në koncentrim e njeriut në punë etj.

- Lokacioni i objektit ku kryhet veprimtaria, burimet e zhurmës vijnë nga automjetet transportuese që nevojiten për transportimin e mbeturinave.
- Sipas gjendjes faktike të objektit në lokacionin e analizuar, si dhe duke marrë për bazë llojin e projektit, kapacitetin e impiantit dhe impianti është i vendosur në hapësira të mbyllura, mundë të konstatojmë se niveli i zhurmës nuk ka ndonjë ndikim të theksuar në mjedis.

6.7. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore

“EURO STEEL” SH.P.K. zona kadastrale Ramun, komuna e Pejës, qendra për grumbullimin, transportimin, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit dhe magazinimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura, gjasat e ndodhjes së aksidentit vlerësohen në bazë të dhënave mbi ngjarjet dhe aksidentet në pajisjet (stabilimentet) e njëjta ose të ngjashme në vendet tjera dhe të dhënave të përfituara nëpërmjet identifikimeve të rreziqeve. Pasojat e mundshme për jetën dhe shëndetin e njerëzve dhe mjedisin parashtrihen në bazë të dhënave të përfituara me analizën e cënueshmërisë.

Me anë të analizës së cënueshmërisë evidentohen të gjitha entitetet dhe objektet e cënueshme në rrethinën e burimit potencial të aksidentit:

- të punësuarit në kompleks
- pjesëmarrësit në trafik dhe rrugë
- objektet afariste dhe të banimit

6.8. Ndikimi mjedisor nga mbeturinat

“EURO STEEL” SH.P.K. Ramun, komuna e Pejës, qendra për grumbullimin, transportimin, trajtimin fizik, ripërdorimit, përpunimit dhe magazinimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura, klasifikimi i mbeturinave bëhet sipas kodeve të Katalogut Shtetëror të Mbeturinave:

Tabela 1. Paraqitja e mbeturinave sipas katalogut shtetëror

Mbeturinat sipas katalogut shtetëror			
Numri sipas katalogut shtetëror të mbeturinave	Emri i Mbeturinës	Shkalla e rrezikshmërisë	Lloji i planifikuar për deponimi të mbeturinave
20 03 01	Mbeturina të përziera komunale	Jo të rrezikshme	Kontejner për mbeturina

“EURO STEEL” SH.P.K., përmes aktiviteteve të saj në trajtimin e mbeturinave, ka disa ndikime mjedisore të rëndësishme. Këtu janë disa nga këto ndikime:

Ndotja e Ajrit

- Pluhuri dhe Partikulat: Aktivitetet e seleksionimit dhe trajtimin mund të shkaktojnë krijimin e pluhurit, që gjithashtu kontribuon në ndotjen e ajrit.

Ndotja e Ujërave

- Derdhjet e Mbeturinave: Derdhja e mbeturinave të lëngshme mund të ndotin ujërat sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, duke rrezikuar burimet e ujit të pijshëm.

Ndotja e Tokës

- Kontaminimi i Tokës: Depozitimi i mbeturinave pa trajtim të duhur mund të çojë në ndotjen e tokës, duke ndikuar në strukturën dhe fertilitetin e saj.

6.9. Trashëgimia Kulturore

Si pas hulumtimit të materialeve përkatëse dhe nga informatat e siguruar në teren dhe komunë, në lokacionin e ngushtë, ku gjendet qendra për grumbullimin, transportimin, trajtimin fizik, ripërdorimit, përpunimit dhe magazinimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura nga “EURO STEEL” SH.P.K., nuk kemi monumente të trashëgimisë kulturore, historike e natyrore të cilat eventualisht do të ndikoheshin apo rrezikoheshin nga ushtrimi i veprimtarisë së kompanisë në fjalë.

7. PËRSHKRIMI I PASOJAVE TË MUNDËSHME NË MJEDIS

“EURO STEEL”SH.P.K., qendra e mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit dhe magazinimit, të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura sjell një sërë pasojash potenciale në mjedis. Më poshtë, pasojat janë të ndara në shumë kategori për një analizë më të hollësishme:

Ndotja e Ajrit

- Proceset e grumbullimit, seleksionimit dhe përpunimit të mbeturinave përfshijnë ndarjen dhe përzgjedhjen e materialeve të ndryshme, të cilat mund të çojnë në lëshimin e pluhurit dhe gazrave të dëmshëm. Gjatë seleksionimit, krijohet pluhur nga materialet si plastika dhe letër, i cili mund të përmbajë substanca të dëmshme, të cilat ndotin ajrin dhe përbëjnë një rrezik për shëndetin e punonjësve dhe të komunitetit përreth.

Ndotja e Ujerave

- Mbeturinat që përmbajnë kimikate të dëmshme, si vajra, bateri dhe metale të rënda, mund të depërtojnë në ujërat sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, duke shkaktuar kontaminimin e burimeve ujore.
- Lëngjet dhe substancat kimike që lëshohen gjatë procesit të grumbullimit dhe përpunimit të mbeturinave mund të arrijnë në ujërat sipërfaqësorë (lumenj, liqene) dhe nëntokësorë përmes rrjedhjes sipërfaqësore ose infiltrimit nëntokësor.

Ndotja e Tokës

- Proceset e grumbullimit, seleksionimit dhe përpunimit të materialeve, përveç krijimit të ndotjes ajrore, mund të çojnë në kontaminim të tokës me substanca të dëmshme, të cilat mund të depërtojnë në thellësi të saj dhe të ndikojnë në cilësinë e mjedisit dhe shëndetin e ekosistemeve. Mbeturinat plastike, metale të rënda, bateritë e përdorura dhe vajrat e konsumuar përmbajnë kimikate dhe elemente të dëmshme që mund të shkaktojnë kontaminimin e tokës.

Ndikimi në Biodiversitet

- Zhvillimi industrial mund të ketë sjellë shkatërrimin e habitatit për shumë specie bimore, duke kufizuar rritjen e tyre dhe duke reduktuar diversitetin biologjik. Ndryshimet në peizazh mund të krijojnë kushte që lehtësojnë shfaqjen e specieve invazive.

8. PËRSHKRIMI I METODAVE PËR VLERËSIMIN E PASOJAVE MJEDISORE

Metodat për vlerësimin e pasojave mjedisore janë të rëndësishme për menaxhimin dhe minimizimin e ndikimeve negative që mund të kenë projektet dhe aktivitetet në mjedis. Për të siguruar që një sistem menaxhimi mjedisor të jetë efektiv dhe të përmbushë standardet, përdoren disa metoda të caktuara që ndihmojnë në vlerësimin dhe monitorimin e ndikimeve. Ja disa nga këto metoda të përdorura për vlerësimin e pasojave mjedisore:

➤ Vlerësimi i Ndikimeve Mjedisore (VNM)

Vlerësimi i Ndikimeve Mjedisore është një metodë që shqyrton ndikimet e mundshme të një projekti në mjedis para se të fillojë ai. Ky proces përfshin:

- **Studimi dhe Analiza:** Identifikimi i ndikimeve potenciale dhe vlerësimi i efekteve të mundshme mbi ajrin, tokën, ujin, florën dhe faunën.
- **Raportimi:** Krijimi i një raporti të detajuar që përmbledh gjetjet dhe rekomandimet për masat e zbutjes.
- **Konsultimi:** Angazhimi i palëve të interesuara dhe publikimit të raportit për të marrë feedback dhe për të siguruar transparencë.

➤ Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit (SMM)

Një Sistem i Menaxhimit të Mjedisit është një metodë sistematike për të menaxhuar dhe kontrolluar ndikimet mjedisore të një organizate. Ky sistem përfshin:

- **Planifikimi:** Identifikimi i ndikimeve dhe krijimi i planeve për të përmbushur kërkesat mjedisore.
- **Implementimi:** Zbatimi i politikave dhe procedurave për të menaxhuar ndikimet mjedisore.
- **Kontrolli dhe Monitorimi:** Monitorimi i performancës mjedisore dhe auditimi për të siguruar përputhshmërinë me standardet dhe rregulloret.
- **Përmirësimi:** Rishikimi dhe përmirësimi i procedurave për të përmirësuar performancën mjedisore.

➤ Analiza e Ciklit të Jetës (ACJ)

Analiza e Ciklit të Jetës shqyrton ndikimet mjedisore të një produkti gjatë të gjithë ciklit të tij, nga ekstraktimi i lëndëve të para deri në përdorim dhe asgjësim. Ky proces përfshin:

- **Hulumtimi i Ndikimeve:** Vlerësimi i ndikimeve gjatë fazave të ndryshme të ciklit të jetës së produktit.

- **Krahasimi:** Krahasimi i ndikimeve të ndryshme për të identifikuar mundësitë për përmirësim.
- **Raportimi:** Krijimi i një raporti që tregon ndikimet dhe rekomandimet për përmirësim.

➤ Studimi i Ndikimeve Ambientale dhe Shëndetësore (SNASh)

Studimi i Ndikimeve Ambientale dhe Shëndetësore shqyrton ndikimet e një projekti jo vetëm në mjedis, por edhe në shëndetin e njeriut. Ky studim përfshin:

- **Analiza e Rrezikut për Shëndetin:** Vlerësimi i rreziqeve të mundshme për shëndetin nga ndotja dhe ekspozimi ndaj substancave të dëmshme.
- **Studimi i Efekteve në Komunitet:** Analiza e ndikimeve në cilësinë e jetesës dhe shëndetin e komunitetit përreth.

➤ Analiza e Rrezikut Ambientale

Analiza e Rrezikut Ambientale fokusohet në identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve që një projekt mund të sjellë për mjedisin. Ky proces përfshin:

- **Identifikimi i Rreziqeve:** Përcaktimi i mundësive dhe probabilitetit të ndodhisë së incidenteve ndotëse.
- **Vlerësimi i Pasojave:** Analiza e pasojave për ambientin në rast të ndodhisë së këtyre incidenteve.

9. PERSHKRIMI I MASAVE

Sipas analizës së bërë mbi ndikimin e qendrës së mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit dhe magazinimit, të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura, si dhe në bazë të vlerësimit i cili është ndërtuar sipas projektit dhe rekomandimeve të dhëna në këtë raport, fabrika e kompanisë “EURO STEEL” SH.P.K., me veprimtarinë kontinuele të sajë në lokacionin e analizuar nuk rrezikon mjedisin sepse respektohen rekomandimet dhe janë ndërmarr të gjitha masat adekuate për zvogëlimin e ndikimeve negative që shpijnë deri te rrezikimi i mjedisit jetësor, gjerë në vlerat kufitare të lejuara. Me qëllim të zvogëlimit të mëtejshëm të ndikimeve potenciale negative në mjedis, rekomandohet ndërmarrja e masave të cilat bëjnë pjesë në domenin e menaxhimit të rrezikut nga qendra e grumbullimit të mbeturinave në rrethanat e jashtëzakonshme dhe të rregullta.

9.1. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër

Për të reduktuar ndikimet në ajër gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit të kompanisë "EURO STEEL" SH.P.K., mund të merren disa masa për të menaxhuar dhe minimizuar ndotjen e ajrit dhe për të mbrojtur shëndetin e punonjësve dhe komunitetit përreth.

-  **Masat gjatë fazës së ndërtimit** - Përdorimi i sistemeve të lagështirës për të reduktuar shpërndarjen e pluhurit gjatë ndërtimit. Rregullimi dhe mirëmbajtja e rregullt e makinave për të siguruar që ato të funksionojnë me efikasitet të lartë dhe të lëshojnë sa më pak gazra ndotës. Instalimi i sistemeve për filtrimin e gazrave të ndotur që lëshohen nga makineritë dhe pajisjet e ndërtimit, si filtra të gazrave të makinave.
-  **Masat gjatë fazës së operimit** - Instalimi i sistemeve të filtrimit dhe ventilimit për të kapur dhe pastruar pluhurin dhe pjesëzat e imta që krijohen gjatë përpunimit të materialeve. Përdorimi i sistemeve të mbrojtjes individuale për punonjësit, si maska dhe pajisje të tjera mbrojtëse, për të zvogëluar ekspozimin ndaj pluhurit dhe substancave të dëmshme. Përdorimi i pajisjeve për kapjen dhe përpunimin e gazrave të dëmshëm si VOCs, për t'i larguar ato nga ajri para se të lëshohen. Sigurimi i sistemeve të ventilimit të përshtatshme në ambiente të brendshme dhe të jashtme për të siguruar që ajri të rritet dhe të përmirësohet vazhdimisht, duke larguar substancat e dëmshme dhe ndihmuar në menaxhimin e pluhurit dhe gazrave. Përdorimi i sistemeve të monitorimit të ajrit për të matur përqendrimet e gazrave dhe pluhurit në ajër dhe për të siguruar që nivelet të jenë brenda kufijve të sigurtë. Për të minimizuar emetimet dhe

ndikimin në ajër, është e rëndësishme të mbahet dhe kontrollohet infrastruktura e qendrës.

9.2. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë

Për të reduktuar ndikimet në tokë gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit të një objekti industrial si ai i kompanisë "EURO STEEL" SH.P.K., janë të nevojshme disa masa për të menaxhuar dhe minimizuar ndotjen e tokës dhe për të mbrojtur ekosistemet përreth.

✚ **Masat gjatë fazës së ndërtimit** - Përdorimi i teknologjive që ndihmojnë në ruajtjen e strukturës së tokës dhe shmangien e kompresimit të tepërt. Mund të përdoren makineri që janë më pak të dëmshme për tokën dhe që mund të ruajnë aftësinë e saj për t'u shkrirë dhe ruajtur ujërat. Sigurimi i menaxhimit të duhur të mbetjeve të ndërtimit, duke i grumbulluar ato për të shmangur shpërndarjen e materialeve ndotëse si pluhur, beton dhe mbeturina të tjera që mund të mbeten në tokë. Përdorimi i sistemeve të mbyllura për grumbullimin e materialeve, duke minimizuar shpërndarjen e tyre në ambientin përreth dhe në tokë. Shmangia e dëmtimit të ekosistemeve natyrore dhe ruajtja e shtresave të tokës dhe bimësisë natyrore që mbështesin biodiversitetin, përmes planifikimit të kujdesshëm të fazës së ndërtimit.

✚ **Masat gjatë fazës së operimit** - Derdhjet e vajrave të përdorura dhe kimikateve gjatë grumbullimit dhe transportit të mbeturinave mund të shkaktojnë ndotje të tokës. Për të parandaluar këtë, është e rëndësishme të përdoren pajisje transporti të mbyllura dhe të sigurta që minimizojnë rrezikun e derdhjeve. Mbeturinat që përmbajnë substanca toksike si metale të rënda dhe kimikate duhet të ruhen në kushte të kontrolluara për të parandaluar ndotjen e tokës. Përdorimi i depozitave të mbyllura dhe të siguruara, ku mbeturinat depozitohen dhe trajtohen, ndihmon në mbrojtjen e tokës nga kontaminimi. Vendosja e sistemeve për monitorimin e cilësisë së tokës është një masë thelbësore për të zbuluar ndotjen në fazat e hershme dhe për të ndërmarrë hapa për eliminimin e burimeve të ndotjes. Rezultatet e monitorimit mund të përdoren për të zbatuar masa parandaluese dhe korrigjuese.

9.3. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë

Për të reduktuar ndikimet negative në ujë gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit të një objekti industrial si ai i kompanisë “EURO STEEL” SH.P.K., janë të nevojshme disa masa për

menaxhimin dhe mbrojtjen e burimeve ujore dhe ekosistemeve ujore. Ja disa masa që mund të merren për të parandaluar ndotjen dhe për të ruajtur cilësinë e ujit:

✚ **Masat gjatë fazës së ndërtimit** - Përdorimi i sistemeve për kontrollin e pluhurit, si spërkatësit me ujë, për të parandaluar shpërndarjen e pluhurit dhe grimcave që mund të ndotin burimet ujore pranë zonës së ndërtimit. Grumbullimi i mbetjeve ndërtimore (si pluhur, materiale ndërtimi dhe mbeturina të tjera) dhe depozitimi i tyre në mënyrë të sigurt për të parandaluar që ato të shpërndahen në rrjedhat ujore.

✚ **Masat gjatë fazës së operimit** - Ujërat e ndotura që dalin nga proceset e grumbullimit dhe përpunimit duhet të trajtohen përpara se të lëshohen në mjedis. Vendosja e sistemeve të monitorimit të cilësisë së ujit është një masë kyçe për të zbuluar ndotjen e ujit në fazat e hershme. Me anë të monitorimit të vazhdueshëm, mund të identifikohen substancat e rrezikshme që mund të jenë shkarkuar në ujërat sipërfaqësorë dhe të merret masa e duhur për pastrimin e ujit para se të përdoret për qëllime të tjera. Zbatimi i teknologjive të avancuara për filtrimin e substancave toksike, si p.sh. filtrat me aktivizim të karbonit ose membrane të përparuara, mund të ndihmojnë në largimin e metaleve të rënda dhe substancave të tjera kimike nga ujërat e ndotura. Këto teknologji mund të përdoren për të trajtuar ujërat e ndotura përpara se ato të shkarkohen në mjedis. Gjatë transportit të mbeturinave dhe materialeve të ndryshme, mund të ndodhin derdhje të vajrave ose kimikateve, të cilat mund të ndotin ujërat nëse nuk trajtohen siç duhet. Pajisjet transportuese duhet të jenë të mbyllura dhe të siguruara për të parandaluar rrjedhjet. Çdo derdhje duhet të pastruar menjëherë, dhe substancat e lëna në sipërfaqe duhet të trajtohen me materiale që thithin dhe neutralizojnë kimikatet.

9.4. Masat për mbrojtje nga zhurma

Masat për mbrojtjen nga zhurma janë të rëndësishme për të minimizuar ndikimet negative të zhurmës në ambientin e punës dhe rrethinën përreth qendrës së mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit dhe magazinimit, të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura. Aktivitetet industriale të tilla mund të krijojnë nivele të larta zhurme për shkak të proceseve mekanike, pajisjeve të përdorura për përpunimin dhe transportimin e mbeturinave, dhe lëvizjes së mjeteve të transportit. Këtu janë disa masa për zvogëlimin e ndikimeve të zhurmës:

✚ Një nga masat më efektive për reduktimin e zhurmës është përdorimi i pajisjeve të avancuara dhe të projektuar për të qenë më pak zhurmues. Për shembull, makineritë e

përdorura për seleksionim dhe presim mund të zëvendësohen me modele më të qeta, ose mund të përmirësohet teknologjia e operimit për të reduktuar nivelet e zhurmës.

- ✚ Barrierat akustike mund të ndihmojnë në izolimin e burimeve të zhurmës nga mjedisi përreth. Këto barrierat mund të përfshijnë mure të specializuara, ekrane ose mbulesa të forta që bllokojnë dhe absorbojnë valët e zhurmës. Barrierat mund të vendosen rreth zonave me intensitet të lartë zhurme, si zona ku zhvillohen aktivitetet e përpunimit ose afër rrugëve të transportit të mjetet.
- ✚ Burimet e zhurmës, si motorët, kompresorët dhe makineritë që krijojnë vibrime dhe tinguj të fortë, mund të izolojnë nga pjesët e tjera të ambientit. Kjo mund të arrihet përmes përdorimit të materialeve izoluese dhe montimit të pajisjeve në platforma që absorbojnë vibrimet, duke reduktuar shpërndarjen e zhurmës në mjedisin përreth.
- ✚ Vendosja e sistemeve për monitorimin e niveleve të zhurmës në vendin e punës dhe rreth qendrës është e domosdoshme për të siguruar që nivelet e zhurmës janë në përputhje me normat dhe rregulloret për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë. Ky monitorim mund të identifikojë burimet e zhurmës dhe të mundësojë marrjen e masave parandaluese dhe korrigjuese kur është e nevojshme.

9.5. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë

Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë janë thelbësore për të minimizuar ndikimet negative të qendrës së mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimi dhe magazinimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura, në ekosistemet natyrore përreth. Aktivitetet e tilla mund të shkaktojnë ndryshime në peizazh, dëmtojnë habitatet e kafshëve dhe bimëve, dhe ndikojnë në biodiversitetin e zonës. Masat për mbrojtjen e mjedisit natyror duhet të fokusohen në ruajtjen e ekosistemeve dhe zvogëlimin e dëmeve që mund të shkaktohen gjatë operacioneve të përpunimit të mbeturinave.

- ✚ Përdorimi i teknologjive dhe metodave që minimizojnë ndikimet fizike në habitatet natyrore është thelbësor. Për shembull, mund të përdoren barrierat natyrore për të ruajtur ekosistemet përreth, duke reduktuar ndërhyrjet në to.
- ✚ Nëse ka ndikime të drejtpërdrejta në habitatet natyrore, është e rëndësishme të ndërmerren masa për të rikuperuar dhe rinovuar hapësirat e gjelbra, si p.sh. mbjellja e bimëve dhe restaurimi i ekosistemeve të dëmtuara.

- ✚ Zbatimi i teknologjive që ndihmojnë në ruajtjen e biodiversitetit, si përdorimi i filtrave dhe sistemet e menaxhimit të mbetjeve, që nuk ndikojnë negativisht në florën dhe faunën përreth, mund të zvogëlojë ndotjen dhe dëmtimin e ekosistemeve natyrore.
- ✚ Mbeturinat që përmbajnë substanca të rrezikshme, si kimikate, metale të rënda ose vajra, duhet të ruhen dhe trajtohen në mënyrë të sigurt për të parandaluar ndotjen e tokës dhe ujit, që mund të dëmtojë florën dhe faunën.
- ✚ Përdorimi i sistemeve të monitorimit për të gjurmuar ndikimet në peizazh dhe biodiversitet është i rëndësishëm për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet negative që mund të kenë aktivitetet e qendrës në florën dhe faunën përreth. Ky monitorim mund të përfshijë numërimin e llojeve të ndryshme të bimëve dhe kafshëve, si dhe vlerësimin e shëndetit të ekosistemeve.

9.6. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë

Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë janë të rëndësishme për të siguruar që aktivitetet e qendrës së mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit dhe magazinimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura të kenë sa më pak ndikime negative në jetesën dhe shëndetin e komunitetit përreth. Për të zvogëluar këto ndikime, është e nevojshme të merren disa masa mbrojtëse dhe përmirësuese.

- ✚ Instalimi i sistemeve të avancuara të filtrimit dhe pastrimit të ajrit për të kontrolluar dhe zvogëluar emetimin e substancave të dëmshme, si pluhuri dhe gazrat toksikë. Kjo do të kontribuoni në mbrojtjen e cilësisë së ajrit dhe zvogëlimin e ndikimeve negative në shëndetin e banorëve.
- ✚ Përdorimi i proceseve të automatizuara dhe mbyllura për grumbullimin dhe seleksionimin e mbeturinave mund të reduktojë shpërndarjen e pluhurit dhe gazrave në ajër. Disa procese mund të realizohen në ambiente të mbyllura, duke minimizuar kontaktin e mbeturinave me ajrin e jashtëm.
- ✚ Përdorimi i mjeteve më të pastra dhe të qeta për transportimin e mbeturinave mund të kontribuoni në reduktimin e ndikimeve negative të trafikut, si zhurma dhe ndotja e ajrit. Përdorimi i mjeteve elektrike ose me gaz natyror mund të jetë një opsion për të zvogëluar emetimet.
- ✚ Duhet të sigurohet që rrugët dhe infrastrukturat e transportit për kalimin e automjeteve që transportojnë mbeturinat të jenë të përshtatshme dhe të sigurt. Kjo mund të ndihmojë

në zvogëlimin e mbingarkesës së trafikut dhe të ndihmojë për të parandaluar rritjen e rrezikut të aksidenteve.

9.7. Masat për menaxhimin e mbeturinave

Masat për menaxhimin e mbeturinave fokusohen në trajtimin efikas të tyre për të reduktuar ndikimin negativ në mjedis dhe shëndet. Procesi fillon me grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave në qendra të specializuara, ku ato trajtohen. Ligjet dhe rregulloret luajnë një rol kyç, dhe monitorimin e rregullt për të garantuar që proceset përputhen me standardet ndërkombëtare. Në të njëjtën kohë, ndërgjegjësimi i komunitetit për rëndësinë e menaxhimit të mbeturinave është thelbësor për të siguruar që këto masa të jenë të suksesshme dhe të qëndrueshme në planin afatgjatë.

9.8. Masat rehabilituese

Masat rehabilituese pas përfundimit të aktiviteteve të një kompanie që operon në mbledhje, grumbullim, transportim, trajtim fizik, ripërdorimit, përpunimit dhe magazinimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura, siç është rasti i kompanisë “EURO STEEL”SH.P.K., janë të rëndësishme për të siguruar që mjedisi të kthehet në një gjendje të sigurt dhe të qëndrueshme për njerëzit dhe natyrën. Këto masa kanë për qëllim të minimizojnë ndikimet mjedisore afatgjata dhe të përmirësojnë gjendjen ekologjike pas përfundimit të aktiviteteve industriale. Në përgjithësi, masat rehabilituese mund të ndahen në disa etapa dhe përfshijnë procedura për pastrimin, rikuperimin dhe restaurimin e mjedisit të ndikuar nga aktivitetet e kompanisë. Këtu janë disa nga masat kryesore që duhet të merren:

- Pastrim i Zonës dhe Heqja e Mbeturinave të Pashfrytëzuara - Pas përfundimit të aktiviteteve, duhet të realizohet një pastrim i plotë i të gjitha hapësirave ku janë trajtuar dhe depozituar mbeturinat. Kjo përfshin heqjen e mbetjeve të ngurta, materialeve të papërdorura, dhe çdo substancë të dëmshme që mund të jetë lënë pas gjatë operacioneve. Kjo përfshin largimin e plastikave, metaleve, baterive dhe substancave kimike të rrezikshme që mund të kenë mbetur në tokë ose ujë. Mbeturinat që mund të riciklohen, si plastikë, letër, metal dhe materiale të tjera, duhet të dërgohen për përpunim të mëtejshëm ose riciklim në impiante të specializuara.
- Menaxhimi i Mbeturinave të Rrezikshme dhe Kontaminimi - Mbeturinat e rrezikshme, si vajrat e përdorura, bateritë, substancat kimike dhe mbetjet e tjera të dëmshme, duhet të trajtohen dhe depozitohen në mënyrë të sigurt për të parandaluar ndotjen e tokës dhe

ujërave. Heqja dhe neutralizimi i këtyre substancave është një hap i domosdoshëm në procesin rehabilitues.

- Rikuperimi dhe Restaurimi i Peizazhit - Pasi janë larguar mbeturinat dhe janë trajtuar substancat e dëmshme, duhet të investohet në restaurimin e peizazhit të ndikuar nga aktivitetet industriale. Kjo mund të përfshijë mbjelljen e bimëve dhe pemëve, krijimin e parkut të gjelbër dhe rikthimin e ekosistemeve natyrore që mund të kenë pësuar dëme. Pjesë të ekosistemeve natyrore, si habitatet e kafshëve dhe bimëve, mund të kenë pësuar dëme gjatë operimeve. Pas mbylljes së aktivitetit të kompanisë, mund të jetë e nevojshme restaurimi i këtyre habitateve, për shembull, mbjellja e bimëve dhe rivendosja e biodiversitetit.
- Pastrimi dhe Rikuperimi i Ujërave - Aktivitetet e përpunimit të mbeturinave mund të kenë ndikuar në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Pas mbylljes së qendrës, është e rëndësishme të bëhet monitorimi i cilësisë së ujërave dhe trajtimi i ujërave të ndotura, duke përdorur teknologji të pastrimit të ujit si filtrat dhe sistemet e dekolonizimit. Nëse është e nevojshme, ndotja e ujërave mund të korrigjohet duke përdorur teknika të pastrimit biologjik ose kimik. Nëse gjatë periudhës së operimit ka ndodhur ndotje e ujërave me substanca të rrezikshme, duhet të instalohet një sistem i pastrimit të ujërave të mbledhura, si ato që rrjedhin nga të reshurat atmosferike, për të parandaluar derdhjet e ndotura në lumenj dhe burime ujore.
- Monitorimi i Ndikimeve Pas Mbylljes - Pas përfundimit të aktivitetit të kompanisë, duhet të implementohet një periudhë monitorimi për të vlerësuar ndotjen dhe rikuperimin mjedisor. Ky monitorim përfshin testimin e cilësisë së ajrit, ujit, tokës dhe biodiversitetit. Mbikëqyrja e vazhdueshme është e domosdoshme për të siguruar se rehabilitimi ka pasur sukses dhe që nuk ka pasur ndotje të mëtejshme. Edhe pas mbylljes së aktivitetit, ndonjë ndikim afatgjatë mund të mbetet në mjedis. Për këtë arsye, është e rëndësishme që të vazhdojë një vlerësim i vazhdueshëm i ndikimeve të mundshme dhe që të merren masa korrektuese, nëse është e nevojshme.
- Zbatimi i Planit të Sigurisë dhe Mbrojtjes Sociale - Pas përfundimit të aktiviteteve, është e rëndësishme që komuniteti lokal të përfshihet në procesin e rehabilitimit dhe restaurimit të mjedisit. Angazhimi i banorëve dhe grupimeve lokale në aktivitete mbrojtjeje dhe restaurimi mund të ndihmojë në promovimin e qëndrueshmërisë dhe edukimin për ruajtjen e mjedisit.

Implementimi i këtyre masave do të ndihmojë në rikuperimin e mjedisit dhe në rivendosjen e ekosistemeve pas ndikimeve negative të aktiviteteve industriale.

9.9 Komponentë mjedisore, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve

Komponenti mjedisore	Potenciali për ndikim negativ	Veprimi që shkakton ndikimin	Masat që duhet të ndërmerren
Ajri	Ndotje nga pluhuri, gazrat toksike dhe substancat ndotëse	Proceset e seleksionimit, presimit, djegies dhe transportit	Instalimi i filtrave të ajrit, përdorimi i teknologjive mbyllëse, monitorimi i rregullt i emetimeve.
Uji dhe Toka	Ndotje e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Degradimi dhe kontaminimi nga mbetjet toksike	Rrjedhje nga bateritë, vajrat dhe mbetjet kimike. Rrjedhje të lëngjeve toksike dhe depozitimi i pakontrolluar i mbetjeve.	Depozita të izoluar, trajtimi i ujërave industriale dhe parandalimi i rrjedhjeve aksidentale. Përdorimi i bazamenteve të papërshkueshme, izolimi i mbetjeve dhe monitorimi i tokës për ndotje.
Natyra dhe biodiversiteti (flora dhe vegjetacioni, fauna, Zonat e mbrojtura të natyrës)	Ulje e diversitetit gjenetik dhe dëmtim i ekosistemeve. Reduktim i mbulimit bimor dhe ndotje nga substancat toksike. Helmim dhe zhvendosje e kafshëve nga habitatet e tyre	Ndotje e përgjithshme e mjedisit, përhapja e substancave të rrezikshme. Shpërndarja e mbetjeve dhe rrjedhjet toksike. Shpërndarja e mbetjeve toksike dhe ndotja e ujit dhe tokës	Menaxhimi i mbetjeve sipas standardeve dhe implementimi i masave mbrojtëse për ekosistemet. Ruajtja e habitateve natyrore dhe përdorimi i metodave që minimizojnë ndikimin në bimësi. Krijimi i zonave mbrojtëse, izolimi i mbetjeve toksike dhe rehabilitimi i habitateve pas përfundimit të operacioneve.

Zhurma	Ndikim negativ në komunitetin përreth	Përdorimi i pajisjeve të zhurmshme dhe operacionet gjatë natës	Instalimi i barrierave akustike, kufizimi i orëve të punës dhe mirëmbajtja e pajisjeve për të reduktuar zhurmën.
Shëndeti i qytetareve dhe konsumatorëve	Sëmundje respiratore, helmime dhe probleme shëndetësore	Emetime të gazrave toksike, ndotje e ujit dhe zhurmat e tepërta	Trajnimi i stafit, informimi i komunitetit dhe zbatimi i protokolleve të sigurisë dhe emergjencave.

Kjo tabelë përfshin të gjithë komponentët e mjedisit, duke dhënë një qasje të detajuar mbi potencialet për ndikim, burimet e këtyre ndikimeve dhe masat që duhet të merren për parandalimin e tyre.

10. PËRSHKRIMI I PASOJAVE NEGATIVE MJEDISORE

Sa i përket aksidenteve apo katastrofave të mëdha që lidhen “EURO STEEL” SH.P.K., qendër e mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit dhe magazinimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura, nuk kemi fare rrezik, rrezik minimal mund të kemi vetëm nga energjia elektrike e cila mund të djeg ndonjë makine apo ndonjë instalim elektrik, por edhe për këtë kompania i ka marruar të gjitha masat duke siguruar aparate për fikjen e zjarrit.

11. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Monitorimi i ndikimeve mjedisore është një proces kyç për menaxhimin e aktiviteteve industriale. Ai është i domosdoshëm për të siguruar që operacionet e qendrës së mbeturinave nuk dëmtojnë mjedisin dhe për të përmbushur kërkesat ligjore. Aktivitetet e qendrës së mbeturinave kërkojnë një monitorim të vazhdueshëm dhe të sistematizuar të treguesve mjedisore, përfshirë cilësinë e ajrit, ujit dhe tokës. Kjo ndihmon në identifikimin e shpejtë të ndotësve dhe të ndikimeve negative që mund të ndodhin. Produktet dhe ndikimet në mjedis do të kontrollohen rregullisht për të siguruar se ato përputhen me standardet e caktuara dhe me legjislacionin përkatës. Çdo rast i ndotjes ose shkeljes së standardeve do të trajtohet me seriozitet. Nëse identifikohen ndikime negative, do të merren masat e nevojshme për të adresuar situatën, përfshirë ndalimin e aktiviteteve që shkaktojnë ndotje dhe implementimin e masave të zbutjes. Çdo rast i ndotjes që tejkalon normat e lejuara do t'i raportohet organit kompetent, në përputhje me ligjet e aplikueshme, për të siguruar transparencën dhe përgjegjshmërinë.

Raportimi është një proces i rëndësishëm që siguron informacion të detajuar mbi gjendjen e mjedisit dhe ndikimet e aktiviteteve të qendrës së mbeturinave. Raportimi do të kryhet nga një individ i autorizuar nga menaxheri i kompanisë. Ky person do të jetë përgjegjës për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, si dhe për përgatitjen e raportit. Në raport do të përfshihen të dhëna të detajuara për monitorimin e parametrave mjedisore që kërkohen në Pëlqimin Mjedisor, i cili lëshohet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPHI). Këto të dhëna mund të përfshijnë:

- Emisionet e gazrave ndotës.
- Cilësia e ujit dhe ndotësit në ujëra të mbeturinave.
- Parametrat e cilësisë së tokës.

Në raport, eventualisht do të përfshihen të dhënat për monitorimin e të gjitha parametrave të cilët do të jenë kërkuar në Pëlqimin Mjedisor (lejen mjedisore e cila lëshohet pasi të pajisemi me Pëlqim Mjedisor nga MMPHI).

12. PËRFUNDIM

Duke i analizuar të gjitha parametrat e procesit të punës se mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit dhe magazinimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura klasifikimi i mbeturinave që do të ndërtohet në Pejë, ndikimet të cilat ndikojnë në mjedisin jetësor dhe duke i zbatuar të gjitha masat e përmendura nga kjo analizë e bërë si dhe duke pasur parasysh kapacitetin e fabrikës dhe mjedisin rrethues të lokacionit mundë të përfundojmë se: Funksionimi kontinual i qendrës për mbledhje, grumbullim, transportim, trajtim fizik, ripërdorimit, përpunimit, dhe magazinimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura klasifikimi i mbeturinave është analizuar dhe përshkruar mjaftueshëm lidhur me ndikimet në mjedis dhe rrezikun eventual që paraqet për mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe në pikëpamje të mbrojtjes së mjedisit në përgjithësi.

Tabela 2. Kodet e mbeturinave sipas katalogut shtetëror të Kosovës

Tabelave e kodeve të mbeturinave me të cilat do të punoj kompania “EURO STEEL” SH.P.K.				
02 01 04	15 01 09	16 02 14	17 04 01	20 01 02
02 01 10	15 02 02 *	16 02 15*	17 04 02	20 01 10
03 03 08	16 01 03	16 02 16	17 04 03	20 01 11
07 02 03*	16 01 04*	16 06 01*	17 04 04	
07 02 13	16 01 06	16 06 02*	17 04 05	20 01 25
10 03 05	16 01 07*	16 06 03*	17 04 06	20 01 33*
12 01 07*	16 01 09*	16 06 04	17 04 07	20 01 34
12 01 10*	16 01 17	16 06 05	19 12 01	20 01 35*
13 04 01*	16 01 18	16 06 06*	19 12 02	20 01 36
15 01 01	16 01 19	16 07 08*	19 12 03	20 01 38
15 01 02	16 01 20	16 08 01	19 12 04	20 01 39
15 01 03	16 02 09*	16 08 02*	19 12 05	20 01 40
15 01 04	16 02 10*	16 08 03	19 12 07	20 03 01
15 01 05	16 02 11*	17 02 01	19 12 08	
15 01 06	16 02 12*	17 02 02	19 12 12	
15 01 07	16 02 13*	17 02 03	20 01 01	

Duke u bazuar në natyrën e punës së qendrës dhe aktivitetit të sajë, vendndodhjen, kapacitetin dhe intensitetin e veprimeve, mund të konstatohet se ndikimet në mjedisin lokal janë minimale, dhe tërësisht të kontrollueshme. Mendojmë se këto të dhëna janë të mjaftueshme për raport të VNM-së dhe i propozojmë institucionit kompetent përkatësisht Ministrisë së Mjedisit,

Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturë (MMPHI), për dhënien e mendimit pozitiv për Pëlqim Mjedisor për rritjen e numrit të kodeve sipas kërkesës së investitorit – qendra e mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit dhe magazinimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura klasifikimi i mbeturinave që do të ndërtohet në Ramun, Komuna e Pejës.

13. FORMA TABELARE E KOSTOS INVESTIVE

	KOSTO INVESTIVE PËR “EURO STEEL” SHPK - PROJEKTIT	
1	Ndërtimi i Objektit Montazh dhe Depo	75,000.00 €
2	Makina e ndarjes mekanike	40,500.00 €
3	Makineria e presës	25,000.00 €
4	Makineria për presim	20,000.00 €
	Makina për paketim	25,000.00 €
Kosto totale investive për te tri objektet		185,500.00 €

“EURO STEEL” SH.P.K.

Pejë



14. LITERATURA E PERDORUR

Lista e bibliografisë (referencave) së burimeve të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e përfshira në raport.

- *Te dhënat nga Investitori,*
- [Peja to 42.6512171, 20.4102778 - Google Maps](#)
- [Kërko dhe paraqit - KGP](#)
- [LIGJI NR. 08/L-181 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS](#)
- [UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 13/2013 PËR KATALOGUN SHITETËROR TË MBETURINAVE](#)